

1 E hënë, 15 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo  
7 është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër  
8 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup  
9 Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për  
11 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në  
12 sallën e gjyqit.

13 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04752,  
14 ka disa aspekte paraprake që dëshiroj të trajtoj.

15 Së pari, ju rikujtoj të gjithëve që këtë javë orarin e  
16 kemi njësoj si javën e kaluar. Çka do të thotë që Dëshmitari  
17 04752 do të japë dëshmi gjithë ditën e hënë, deri pushimin e  
18 drekës të martën, ditë të plotë të mërkurën dhe vetëm seancën  
19 e parë të enjten. Për këtë javë nuk ka dëshmitar tjetër.

20 Gjithashtu dëshiroj të pyes ZPS-në nëse ka për synim të  
21 dorëzojë si provë materiale faqen U015-8879 të U015-8743 deri  
22 në U015-9047, që përndryshe është faqja 136 e librit të z.  
23 Krasniqi. Po e them këtë, se dhe faqja pararendëse dhe faqja  
24 tjetër janë pranuar si provë gjyqësore po nuk është kërkuar  
25 faqja 136. Çka do të thotë që ka një faqe mangët në provat

1 tona materiale.

2 Znj. Prokurore, nuk është nevoja të përgjigjeni tani,  
3 interesohuni me kolegët dhe na thoni.

4 Dhe paraprakisht do të doja të pyesja Mbrojtjen nëse ka  
5 ndonjë kundërshtim për pranimin e kësaj faqeje si provë  
6 gjyqësore.

7 Të enjten, 11 korrik 2024, Gjykatësi Gaynor i bëri dy  
8 pyetje Mbrojtjes së Krasniqit sa i takon nënshkrimin të z.  
9 Krasniqi dhe përgjimet. Mbrojtja e Krasniqit tha se do të  
10 përgjigjej sot qoftë me gojë apo me shkrim. Rrjedhimisht,  
11 dëshiroj të pyes Mbrojtjen e Krasniqit nëse doni të  
12 përgjigjeni me gojë, ju lutem, bëheni tani. Me gojë?

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, me gojë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë duhet  
15 të kalojmë në seancë private për shkak të çështjes së  
16 përgjimit.

17 Të kalojmë në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
12 jemi në seancë publike. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të  
14 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04752.

15 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin  
17 të hyjë në sallë, desha t'ju thoja që fillimisht kisha kërkuar  
18 rreth dy orë, dy orë e gjysëm, por megjithatë më përpara ju  
19 kisha thanë që mund të më duhet të përdor tetë-orarëshin që  
20 kisha kërkuar fillimisht. Synoj të mbaroj para pushimit të  
21 drekës dhe do të bëj të pamundurën që të përfundoj para  
22 pushimit të drekës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,

1 z. Zyrapi. Mirë se u ktheve.

2 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju rikujtoj,  
4 siç kam bërë çdo ditë tjetër, të përpigëni të përgjigjeni  
5 qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje,  
6 lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e  
7 kuptoni në mënyrë që ta sqarojmë. Gjithashtu mos harroni të na  
8 thoni ku i bazoni ju njohurinë, faktet dhe rrethanat për të  
9 cilat do t'ju bëjnë pyetje.

10 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara  
11 se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për përkthyesit.

12 Në çdo moment në qoftë se keni nevojë për pushim na thoni  
13 dhe do ta bëjmë të mundur.

14 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të  
15 vërtetën sikurse vetë e cituat mes deklaratës solemne.

16 Gjithashtu ju rikujtoj, siç ju thashë edhe javën e  
17 kaluar, nuk e keni për detyrim t'ju përgjigjeni pyetjeve që  
18 janë vetinkriminuese, me përjashtim të rasteve kur ju detyron  
19 Trupi Gjykses. Nëse lind një pyetje e tillë, ju, përmes  
20 Avokatit tuaj mund ta ngrini këtë me Trupin Gjykses dhe do të  
21 vendosim ne pastaj nëse do të përgjigjeni dhe në çfarë  
22 rrethanash mund t'ju detyrojmë që t'i përgjigjeni pyetjes.

23 Vazhdojmë me kundërpjetet tani. Ende e ka fjalën

24 Mbrojtja e z. Krasniqi.

25 Znj. Alagendra, fjala është për ju.

1 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]  
2 Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra:  
3 [Vazhdim]  
4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]  
5 PY. Mirëmëngjesi, z. Zyrapi.  
6 PË. Mirëmëngjesi.  
7 PY. Ditën e enjte e lamë tek prova materiale P228.  
8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të  
9 seancës që ta nxjerrë dokumentin në ekran. Ju lutem, në fund  
10 të dokumentit.  
11 PY. Z. Zyrapi, a është ky nënshkrimi juaj?  
12 PË. Po.  
13 PY. Përkrah nënshkrimit tuaj, shohim inicialet SV? A është ky  
14 një dokument i përpiluar nga Sali Veseli, ish-oficer i  
15 policisë ushtarake?  
16 PË. Po, është --  
17 PY. Më falni -- një ish-ushtarak.  
18 PË. Po.  
19 PY. Shkojmë në faqen e dytë të këtij dokumenti, paragrafi i  
20 fundit, paragrafi c), paragrafi që është me germën c:  
21 "Duhet të punohet më tepër me ushtarët e rinj të  
22 inkuadruar në njësitë e UÇK-së në të gjitha zonat e operative  
23 në këto segmente duke marrë parasysh komandat e mëparshme, të  
24 ketë taktika në luftë në situata të ndryshme manovrimi, në  
25 qitjen e pajisjeve të blinduara si dhe veprime të tjera - më

1 falni - manovrimi, zjarri, organizimi i sistemit të zjarrit  
2 kundër blindëve si dhe veprimeve të ndryshme.”

3 Z. Zyrapi, a pajtoheni me mua që këtu në thelb thuhet që  
4 duhet të ketë aftësim në nivel zone për të qenë në gjendje të  
5 luftosh në situata të ndryshme, përfshirë këtu të jesh në  
6 gjendje të luftosh kundër makinave të blinduara, kështu?  
7 PË. Po, është përgjegjësi për përgatitjen taktike të  
8 ushtarëve, sidomos atyre të rinjve në të gjitha zonat në  
9 territorin e Kosovës dhe të përgatiten normalisht për dhe për  
10 mbrojtjen kundër tankeve.

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani shohim në ekran provën  
12 materiale P01017.

13 PY. Kjo është një urdhëresë për mbrojtjen e territorit,  
14 gatishmërisë luftarake, si dhe përgatitjes drejtuar  
15 komandantëve të zonave. A ju kujtohet t'jua kenë treguar këtë  
16 dokument gjatë seancës përgatitore?

17 PË. Po.

18 PY. A mund të fokusoheni tek pika 3 që thotë:

19 “Të gjithë komandantët e zonave operative, organet dhe  
20 komandave të njësive vartëse të marrin menjëherë veprime për  
21 aftësimin e njësive në përdorimin e armatimit individual e  
22 kolektiv duke shfrytëzuar mundësitë maksimale taktiko-tekniqe  
23 në organizimin e sistemit të zjarrit, sidomos kundër blindës,  
24 kundër këmbësisë, kundër artilerisë dhe në mbrojtje  
25 kundërajrore. Zjarri do të jetë i befasishëm pas shpine,

1 kraharor ..."

2 E kështu me radhë. Kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Kjo është në përputhje me përmbajtjen e raportit që ne  
5 sapo pamë më përpara, apo jo?

6 PË. Po, e saktë.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në fund të dokumentit.

8 PY. Edhe një herë, shohim që ky dokument është përpiluar nga  
9 Sali Veseli dhe është nënshkruar prej jush, kështu?

10 PË. Po. Po, saktë.

11 PY. Z. Zyrapi, nga dokumenti duket se kur lejoheshin, kur  
12 ishin rrethanat e përshtatshme, ju merrnit raporte nga zonat,  
13 i përmbledhnit në një raport të vetëm dhe më pas u lëshonit  
14 udhëzime ushtarake zonave. A ka funksionuar kështu?

15 PË. Po, normalisht.

16 PY. Gjatë seancës përgatitore --

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe referenca për Trupin  
18 Gjykues është 121865 deri në 121896, Shtojca 1, Shënimi  
19 Përgatitor 2, ju keni thënë se këto ishin raporte të bazuara  
20 në raportet që merrnin nga komandantët e zonave që i  
21 dërgoheshin komandantit të përgjithshëm, kështu?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. Tek pika 96, po ashtu keni thënë nëse komandanti i  
24 përgjithshëm donte më shumë informata, atëherë i jepnit  
25 raportin konkret të zonës ose kërkonit ju vetë informata



1 shtesë që t'i përcilleshin atij, kështu?

2 PË. Po, saktë. Po, saktë q'ashtu.

3 PY. Pra, ju pajtoheni me mua, z. Zyrapi, që kur i thatë

4 Prokurorisë se raportet të tilla i dorëzoheshin Jakup

5 Krasniqit, në fakt, kjo ka ndodhur që të mbahej një kopje e

6 tyre në Shtabin e Përgjithshëm dhe t'i kalohej më pas

7 komandantit të përgjithshëm, kështu?

8 PË. Në çdo rregull e ato kur të dërgohet raporti, në qoftë se

9 komandanti nuk është e merr zëvendësi. Kur të vjen komandanti

10 pastaj e merr atë raport. Po zakonisht shkon në këtë mënyrë.

11 Në mungesë të komandantit e merr zëvendëskomandanti. Kështu që

12 zëvendëskomandanti e ka dërguar këtë raport.

13 PY. Në fund të dokumentit shohim në të majtë poshtë

14 inicialeve thuhet:

15 "Arkivës."

16 A thuhet kështu? "Arkivës", poshtë inicialeve?

17 PË. Po, po.

18 PY. Javën e kaluar na thatë që pas ristrukturimit në nëntor

19 të 1998, dokumentet u rishkruan. Pra, a pajtoheni ju me mua që

20 është bërë një përpjekje që të mbahej një arkivë e dokumenteve

21 në Shtabin e Përgjithshëm ose një kopje e këtyre dokumenteve?

22 PË. Po, çdo herë kur të bëhet një urdhëresë apo një dokument

23 që lëshohet nga shtabi apo shefi i shtabit ruhet në arkivë.

24 Për atë është edhe libri i protokollit që edhe kemi pa më

25 herët ku protokolohen këto dokumente dhe arhivohen në shtab,

1 në qoftë se shtabi e ka lëshu e arhivon një kopje për veti në  
2 atë drejtim. Kurse zonat për vete të njëjtë kur e dërgonin një  
3 dokument, i dërgohej njësisive më poshtë një dokument ose një  
4 kopje mbetet si arhivë në komandë ku ai -- kush e ka lëshuar  
5 atë dokument.

6 PY. Dhe, në fakt, prandaj e ka fjalën këtu "arkivës" që të  
7 mbahej një kopje në dokumentacion?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Dhe Jakup Krasniqi ka qenë zëvendëskomandant për  
10 mbështetje në atë kohë dhe shumicën e kohës ka qenë i  
11 pranishëm në Divjakë, saktë?

12 PË. Po, tanë kohën.

13 PY. Edhe Sokol Bashota ka qenë zëvendëskomandant i  
14 operacioneve në atë kohë, po për shkak të dallimeve me  
15 komandantët e zonave ai nuk ishte i pranishëm në Divjakë,  
16 saktë?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Raporti i mëparshëm -- për raportin e mëparshëm thatë që  
19 i është dorëzuar Jakup Krasniqit. Po a pajtoheni me mua që  
20 vetë në dokument që të tregojë apo të vërtetojë që Jakup  
21 Krasniqi ta ketë marrë atë raport? A pajtoheni me mua?

22 PË. Si pikë së parit, raporti është dërgue dhe e ka marrë  
23 zëvendëskomandanti, Jakup Krasniqi, në atë kohë. Ato nuk  
24 shkruajnë aty emri kush e merr. Po shkruhet  
25 "zëvendëskomandanti". Edhe kur shkruhet komandanti nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 11

1 shkruhet emri i komandantit po shkruhet "komandanti". Kështu  
2 që në këtë mënyrë ju ka shkru dhe ju ka dorëzuar, na është  
3 dorëzu ky raport, përmbledhja e raportit, se në atë kohë ka  
4 qenë Jakupi në atë kohë kur është marrë ky raport.

5 PY. Dhe kur raporti thotë "zëvendëskomandant" nuk e  
6 specifikon se për cilin zëvendëskomandant bëhet fjalë. A  
7 pajtoheni me mua?

8 PË. Po, plotësisht.

9 PY. A pajtoheni me mua, z. Zyrapi, që në kuadër të këtij  
10 raportit ose në përmbajtje të këtij raportit është fakt që ata  
11 që ishin në drejtorinë operative që ju raportonin ju, ishin të  
12 vetmit persona që e kishin aftësitë që t'i trajtonin këto  
13 çështje -- çështjet operative për të cilat keni folur në  
14 raportin tuaj? A pajtoheni me mua?

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E kundërshtoj, kjo pyetje është  
16 bërë javën e kaluar dhe ka marrë përgjigje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
18 kundërshtimi.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY. Pajtoheni me mua, z. Zyrapi, që nuk ka asgjë në raport që  
21 ti thua se i është dorëzuar zëvendëskomandantit, Jakup  
22 Krasniqi, nuk thuhet asgjë aty për arrestime, marrje në pyetje  
23 apo keqtrajtime të civilëve në zona, brigada apo në nivel  
24 Shtabit të Përgjithshëm, jam korrekt, e kam saktë?

25 PË. Po. Në këtë raport përmbledhje raporteve, është e saktë.

1 PY. Po ashtu këto raporte nuk thotë gjë që janë në takimet e  
2 mbajtura para lëshimit të këtij raporti të jetë diskutuar  
3 çështje arrestimesh, marrjesh në pyetje apo keqtrajtimesh të  
4 përkrahësve të LDK-së, kështu?

5 PË. Po. Nuk kemi pas si takim.

6 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do lutesha të shfaqni  
7 faqen në ekran P1482.

8 PY. A ju kujtohet që këtë dokument ua treguan në 2 korrik, z.  
9 Zyrapi?

10 PË. Po.

11 PY. Ju kujtohet?

12 PË. Po, më kujtohet.

13 PY. Dhe dëshmia juaj lidhur me këtë dokument, do ju jap dhe  
14 referencën.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Është transkripti i 2  
16 korrikut, faqja 17475, rreshti 22 dhe faqja 17476, në rreshtin  
17 11. Kalon nga 22 pastaj tek faqja tjetër tek 11.

18 PY. Do t'ju lexoj atë që thatë. Ju thatë që:

19 "Ia dërgonit ftesën të gjithë komandantëve që të merrnin  
20 pjesë dhe unë merrja pjesë në takime si pjesë e shtabit."

21 A ju kujtohet që e thatë këtë?

22 PË. Po.

23 PY. Kemi parë ftesa që i keni dërguar ju, z. Zyrapi, po ashtu  
24 kemi parë ftesa që janë drejtuar nga drejtoria për personelin  
25 ose hartuar prej kësaj drejtorie Adem Grabovcit që më pas

1 ish in sipas jush ish in nënshkruar nga Jakup Krasniqi.

2 A pajtoheni me mua z. Zyrapi, se nuk kishte rëndësi kush  
3 ishte personi që i dërgonte këto ftesa? Pra, të dërgoje ftesa  
4 të tilla ishte një çështje, një detyrë administrative, apo jo?  
5 PË. Jo. Kur bëhet thirrje për takime nuk është ka rëndësi, ka  
6 rëndësi se kush e thërret, a e thërret komandanti,  
7 zëvendëskomandanti apo shefi i shtabit. Kjo është me rëndësi  
8 shumë. Nuk është me rëndësi ku shkojnë dokumentet kush e ka  
9 shkruar, me rëndësi është ai kush ai kush e ka ideuar, kush e  
10 ka dhënë idenë të bëhet ai dokument.

11 PY. Do të flasim dhe për këtë përgjigje, z. Zyrapi, pak më  
12 vonë. Tani do të doja të shihnim përmbajtjen e këtij  
13 dokumenti. Dokumenti ka datën 15 janar dhe dy nga temat për  
14 diskutim janë çështjet organizative dhe çështje të tjera,  
15 objektivat afatshkurtër dhe afat gjatë të ushtrisë Çlirimtare  
16 të Kosovës, kështu?

17 PË. Po, saktë.

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran U009-1991 deri  
19 në 992. Të kalojmë tek fundi i faqes nëse mundeni. Jo, e kisha  
20 fjalën për fundin e dokumentit jo të faqes.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
22 versioni në shqip është U009-1191 deri në U009-1994.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do më duhet deri në faqen  
24 1992.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Besoj se pajtoheni me mua, z. Zyrapi, se dokumenti ka  
3 emrin e Ramush Haradinajt, a është e saktë kjo?

4 PË. Po, ka emrin.

5 PY. Po ashtu ka edhe datën 19 janar 1999, a është kështu,  
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Do të thotë që është katër ditë pas ftesës që sapo e pamë  
9 ne që ishte shpërndarë, a është e saktë kjo? E kam fjalën për  
10 dokumentin e mëhershëm që pamë që kishte datën 15 janar,  
11 kështu, Dëshmitar? Doni ta shikoni dhe një herë tjetër nëse  
12 s'e keni të qartë?

13 PË. Po, po. Jo, nuk ka nevojë. E kam parë shumë mirë. Po veç  
14 duhet të kuptojmë dhe një sen, që 15 janar nuk u mbajt takimi  
15 -- ju lutem. Tek 15 janari ta shpjegojmë pak unë. Është e  
16 shkrume 15 janar thirrja, po në 15 janar nuk është organizuar  
17 ai takim. Për arsye se në 15 janar kemi pasur luftimet në  
18 Reçak dhe kjo ka qenë masakra e Reçakut, kështu që është shty  
19 pastaj edhe te thirrja dhe takimi është bërë më vonë.

20 PY. Në rregull. Megjithatë, duke parë ekranin që kemi këtu  
21 ekran, besoj se pajtoheni me mua se data që mban ky dokument  
22 është katër ditë pas ftesës që pamë më herët, a është e saktë  
23 kjo, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë pak më

1 lart në faqe përsëri, Sekretar, tek faqja e parë.

2 PY. Përsëri këtu tek faqja e parë, shihni që ky është një  
3 dokument i cili i drejtohet çështjeve organizative, ka të bëjë  
4 me çështje organizative, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po. Ky është koment të cilin e shkrun nga zonat,  
6 faktikisht, një zone dhe kërkesa që ka pas bë shtabit, po dhe  
7 çështjet organizative brenda asaj zone.

8 PY. Në rregull. Në pamje të parë duket sikur është një  
9 përgjigje ndaj ftesës për takim nga Shtabi i Përgjithshëm, a  
10 është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, është e saktë ky dokument është shkruar në bazë të  
12 pikave të kërkesës që duhet të raportojnë ata në shtab.

13 PY. Në rregull.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani që kalojmë tek pjesa që  
15 fillon me "Çështje organizative". Tek paragrafi i dytë nga  
16 fundi i faqes, në qoftë se mund ta tregoni në ekran, Sekretar.

17 PY. Këtu thuhet dhe do lexoj këtë paragraf:

18 "Kërkoj që të njoftohen komandantët e zonave ose unë si  
19 komandant i zonës së caktuar me kriterin e caktimit të kuadrit  
20 komandues pranë Shtabit të Përgjithshëm. Konkretisht, kërkoj  
21 të di për kriterin e emërimit të Jakup Krasniqit si  
22 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm."

23 A e shikoni këtë paragraf, Dëshmitar?

24 PY. Po.

25 PY. Më pas vijohet më tej me propozim të emërimeve të reja

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 16

1 për komandant të përgjithshëm dhe zëvendëskomandant të  
2 përgjithshëm. A është e saktë kjo, dëshmitar?  
3 PË. Po.  
4 PY. Duket qartazi këtu që Ramush Haradinaj ka marrë një ftesë  
5 me emrin e Jakup Krasniqit dhe me titullin e tij si  
6 zëvendëskomandant dhe gjëja e parë që ai vë në diskutim është  
7 që të kërkojë kriteret që janë përdorur në mënyrë të tillë që  
8 Jakup Krasniqi të emërohej siç është emëruar si  
9 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm, a është e saktë  
10 kjo, Dëshmitar? Domethënë ai po kërkon kriteret e përdorura  
11 për caktimin e Jakup Krasniqit si zëvendëskomandant i Shtabit  
12 të Përgjithshëm.

13 Shikoni dokumentin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
15 znj. Alagendra, jepini kohë dëshmitarit që të dëgjojë  
16 përkthimin dhe të japë përgjigjen. Dhe ndërkohë keni bërë tre  
17 pyetje njëra pas tjetrës pa marrë përgjigjen.

18 DËSHMITARI: Kjartë. Po shkurt me thënë, po, është një  
19 raport që është kërku dhe kriteret.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha, Sekretarit - jo,  
21 një çast ju lutem. Së pari a mund të kërkoj që të pranohet si  
22 provë ky dokument, domethënë, është dokumenti U009-1991 deri  
23 në 1992.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
25 kundërshtime?



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 17

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
3 U009-1991 deri në 1992 pranohet si provë.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dhe do t'i caktohet  
5 numri i provës P4D0073, aktualisht është i klasifikuar si  
6 konfidencial.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë  
8 kundërshtim sa i takon klasifikimit?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
11 Atëherë do ta riklasifikojmë dokumentin si publik.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që  
14 tani të paraqesë në ekran dokumentin P628.

15 PY. A ju kujtohet që e keni parë këtë dokument më datë 2  
16 korrik, z. Zyrapi, që jua ka treguar Prokurori, ju kujtohet?

17 PË. Po.

18 PY. Në paragrafin 2 të këtij dokumenti thuhet që zonave ju  
19 janë dhënë tre numra telefoni, a është e saktë kjo, z. Zyrapi?

20 PË. Po, e saktë.

21 PY. Dëshmia që keni dhënë më 2 korrik dhe do e lexoj nga  
22 transkripti.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për referencë të Gjykatës,  
24 është në faqen 17468, rreshtat nga 10 deri në 17:

25 PY. "Këto numra, numri i parë është numri im si shef i

1 shtabit, numri i telefonit satelit. Ndërkohë numri i dytë  
2 është numri i oficerit të operacioneve që ka marrë raportet.  
3 Ndërkohë që numri i tretë është zëvendëskomandanti i Shtabit  
4 të Përgjithshëm, është numri i tij i telefonit. Në rast se  
5 personat që mbanin numrin e parë dhe të dytë të telefonit nuk  
6 mund të arriheshin dot, atëherë personi që mbante numrin e  
7 tretë të telefonit ishte personi që kontaktohej.”

8 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Numri i telefonit të dhënë ishte numri, e kam fjalën për  
11 numrin e tretë, ishte numri i telefonit që mbahej në shtëpinë  
12 e bardhë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Besoj pajtoheni me mua se kushdo që ishte i pranishëm tek  
15 shtëpia e bardhë në Divjakë mund ta kishte përdorur atë numër,  
16 a është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Nëse vinte një thirrje nga zonat në shtëpinë e bardhë,  
19 mbështetur në dëshminë tuaj, mesazhi që jepej përmes thirrjes  
20 ju jepej ose ju vetë, ty personalisht, ose stafit të  
21 drejtorisë operative, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Prej zonave në qoftë se kanë bërë ndonjë lëvizje ose ka  
23 ndonjë ndryshim në zonat, atëherë po, është thirrur njëherë  
24 oficeri i operativës, faktikisht, pastaj unë. Dhe në qoftë se  
25 në mungesë të neve dyve atëherë është thirr

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 19

1 zëvendëskomandanti.

2 PY. Në rregull. Dhe në qoftë se asnjëri prej jush nuk mund të  
3 kontaktohej, atëherë telefonata shkonte tek shtëpia e bardhë,  
4 domethënë, tek shtëpia e bardhë e merrnin mesazhin, e mbanin  
5 shënim dhe pastaj jua kalonin ju në momentin kur ata mund të  
6 kontaktonin me ju kur ju mund të flisnit, a është e saktë kjo,  
7 Dëshmitar?

8 PË. Po, saktë.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju kërkoja juve, të nderuar  
10 Gjykatës, të kalonin në seancë private.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na kaloni në  
12 seancë private, z. Sekretar.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 21

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

19 jemi në seancë publike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

22 PY. Z. Zyrapi, tani do të kalojmë tek tema se si UÇK-ja ka

23 menaxhuar logjistikën dhe financat e veta. Në rregull?

24 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një ushtri vullnetare,

25 apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Askush në UÇK nuk ka marrë paga, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Po, e saktë është.

4 PY. UÇK-së i nevojiteshin para për të blerë municione, armë,  
5 ushqime, kështu që për këtë arsye është krijuar një fond i  
6 dedikuar që quhej Atdheu Thërret, a është e saktë kjo,  
7 Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Fondi financohej tërësisht përmes kontributeve  
10 vullnetare, kryesisht nga shqiptarë që jetonin në diasporë, a  
11 është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Fondi gjendej jashtë Kosove dhe kishte një zyrë në Tiranë  
14 dhe ky ishte një fond i cili, domethënë, zyra atje menaxhohej  
15 nga Ramiz Lladrovci dhe Halil Selimi, a është e saktë kjo,  
16 Dëshmitar?

17 PË. Po, e saktë.

18 PY. Më 3 korrik na keni thënë z. Zyrapi, se komandanti i  
19 logjistikës i UÇK-së që ishte i stacionuar në Shqipëri ishte  
20 Xheladin Gashi, që ndryshe njihej me nofkën Plaku, a është e  
21 saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Në transkript në faqen 17436, ju thoni që Idriz Hyseni  
24 ishte përgjegjës për njësinë logjistike në Shtabin e  
25 Përgjithshëm në Divjakë dhe, gjithsesi, kjo ishte një njësi e

1 cila merrej vetëm me nevojat e menjëhershme ose urgjente të

2 Shtabit të Përgjithshëm, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po, e saktë.

4 PY. Xheladin Gashi ishte i stacionuar në Shqipëri gjatë

5 gjithë luftës, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Në Pjesën 7, në faqen 13 të intervistës së 2019, keni

8 thënë që drejtoria e logjistikës së Shtabit të Përgjithshëm

9 asnjëherë nuk ka qenë e kompletuar sepse baza e logjistikës

10 ishte jashtë Kosovës, ishte në Shqipëri dhe Xheladin Gashi

11 ishte përgjegjës për të. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Si rezultat i kësaj kishte pak para në dispozicion të

14 Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë në fund të 1998 në fillim

15 të 1999, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Shtabi i Përgjithshëm në Divjakë megjithatë herë pas here

18 merrte dhuratë ose donacione nga civilë brenda Kosovës, a

19 është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po, mirrte sidomos nga këshillat e financave na për

21 komuna, vende që kanë qenë të organizume, herë prej tyre po.

22 Po dhe prej qytetarëve të cilët kanë pas mundësi t'i japin.

23 PY. Komandantë të UÇK-së në nivele të ndryshme në mënyrë të

24 pavarur kanë dërguar kërkesa për mbështetje logjistike në

25 adresë të Plakut, apo jo, në drejtim të Plakut, a është e



1 vërtetë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, ka pasur.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të  
4 paraqesë në ekran dokumentin U017-5901 deri në 6091. Faqja  
5 konkrete është 139 e dokumentit në PDF. Në versionin në shqip  
6 është faqja 128. Besoj se është në faqen 128 në shqip.

7 Mbase e dhashë gabimisht numrin e referencës në shqip,  
8 ndoshta do të ishte më mirë që ta lexoj që të përkthehet për  
9 dëshmitarin.

10 PY. Bëhet fjalë për një libër nga Bardh Hamzaj që e ka  
11 titullin "Një narrativë për luftën dhe lirinë" dhe në këtë  
12 libër --

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kam përshtypjen që në  
14 versionin në anglisht duhet të jetë faqja 136 ose 139 që 138  
15 në PDF.

16 PY. Pra, thuhet që:

17 "Shpesh herë kërkesat nga Kosova merreshin parasysh kur  
18 kisha nevojë për pajisje dhe kur i kontrabandoja ata këtu. I  
19 dërgoja njerëzit atje, i merrja pajisjet pa pyetur asnjë  
20 njeri. Kjo është mënyra sesi thuajse të gjithë e kanë dëmtuar  
21 këtë mekanizëm logjistike. Sa më përket mua, unë duhej që të  
22 veproja. Gjithmonë e kam kuptuar mungesën e efektivitetit të  
23 këtij mekanizmi dhe kam humbur besimin që ky mekanizëm mund të  
24 më ndihmonte për pajisjet e nevojshme. Për këtë arsye unë  
25 krijova një mekanizëm paralel logjistike dhe kam vendosur

1 Mustafa Selmanaj si shef ose si drejtues të tij.”

2 A pajtoheni me mua, z. Zyrapi, se Ramush Haradinaj  
3 kryesisht ka kërkuar logjistikë nga qendra e logjistikës së  
4 UÇK-së e stacionuar në Shqipëri, a është e vërtetë kjo,  
5 Dëshmitar?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Dhe pas ca kohe ai nuk e bëri më këtë gjë dhe krijoi një  
8 tjetër mekanizëm paralel për logjistikën, a është e vërtetë,  
9 është kështu?

10 PË. Faktikisht ai mundua në atë drejtim ta bëni dhe një  
11 paralel. Për të gjithë ata njerëz të cilët kanë furnizue këtë  
12 zonë kanë qenë të bazës së logjistikës së UÇK-së po që kanë  
13 qenë të dedikuar drejt për zonën e Dukagjinit. Kështu që ai ka  
14 konsideru që e ka bërë një farë vije veçantë, por jo, ajo ka  
15 qenë në kuadër të bazës së logjistikës pranë UÇK-së.

16 PY. Në rregull. Të kalojmë te zona e Llapit.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Përpara se të vazhdojmë më  
18 tej, të nderuar Gjykatës, do kërkoja që kjo faqe të pranohet  
19 si provë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pjesa  
22 përkatëse është identifikuar në procesverbal dhe nuk kemi  
23 asnjë kundërshtim për sa i takon pranimin të kësaj faqeje si  
24 provë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Dokumenti U017-5901 deri në U017-0691 në faqen 139 në anglisht  
2 dhe në faqen 128 në shqip, pranohet.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam  
4 referencën e saktë për versionin e dokumentit në shqip tani.  
5 Është dokumenti U002-3238. Faqja konkrete që tregova apo që  
6 lexova është U002-3310.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
8 Atëherë kjo faqe pranohet si versioni në shqip. Ju lutem  
9 caktoi një numër prove.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
11 Gjykatës. Faqja 139 në anglisht, që është nga dokumenti U017-  
12 0639 dhe dokumenti përkatës në shqip, që është dokumenti U002-  
13 3239, konkretisht faqja U002-3210, do të marrin numrin e  
14 provës 4D00074 dhe aktualisht është i klasifikuar si material  
15 konfidencial.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

18 PY. Tani do të kaloj tek zona e Llapit, z. Zyrapi. Sikurse e  
19 dini, komandanti i zonës për Llapin ishte Rrustem Mustafa. Dhe  
20 Rrustem Mustafa ka dhënë dëshmi për këtë Trup Gjykses. A e ke  
21 dëgjuar dëshminë e dhënë nga z. Mustafa, z. Zyrapi?

22 PË. Po. Jo të gjithën.

23 PY. Në rregull. Z. Mustafa ka dëshmuar se ka pasur mundësi që  
24 të siguronte armë për zonën e Llapit nga Bosnja dhe nga Serbia  
25 gjatë luftës. Ju nuk është se e kundërshtoni këtë, apo jo?

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndërkohë sipas transkriptit të  
2 Gjykatës, në transkript, pra, në faqen 5882, të datës 17  
3 korrik thuhet kjo që unë sapo citova më sipër.

4 PY. Ju nuk e kundërshtoni këtë, apo jo, Dëshmitar?

5 PË. Cila ke pyetja tash?

6 PY. Që z. Mustafa ka dhënë dëshmi që ka pasur mundësi që të  
7 sigurojë armë për zonën e Llapit nga Bosnja dhe Serbia gjatë  
8 luftës. Ju nuk e kundërshtoni këtë, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po, saktë. Po saktë ashtu është.

10 PY. Ai ka shtuar gjithashtu që ka shtuar kontribute  
11 vullnetare nga disa njerëz, pra, kontribute monetare  
12 vullnetare që ishin dhënë si brenda Kosovës dhe jashtë  
13 Kosovës. A jeni në dijeni të kësaj gjëje, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, sa i takon aspektit logjistik dhe financiar, zonat  
16 kishin një linjë të pavarur për furnizimet dhe për financime  
17 edhe Shtabi i Përgjithshëm në Divjakë nuk kishte kontroll, apo  
18 jo?

19 PË. Po, saktë është.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë po  
21 shoh orën.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
23 bëjmë dhjetë minuta pushim tani.

24 Ju lutem shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë  
2 minuta pushim.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

4 --- Seanca rifillon në orën 10.10

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
6 sillni dëshmitarin në sallë.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju lutesha të kalojmë në  
8 seancë private, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
10 Alagenda, çfarë thatë?

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Thashë të kalojmë në seancë  
12 private për dokumentin e radhës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
14 të kalojmë në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 30

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislime Zyrapi (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 31

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Bislir Zyrapi (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 32

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë

25 publike.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Alagendra, përsëriteni pyetjen.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Z. Zyrapi, a ju kujtohet që jua treguan këtë dokument më  
5 datën 2 korrik të këtij viti, z. Zyrapi?

6 PË. Po. Po, më kujtohet.

7 PY. Dhe në dëshminë tuaj, thatë që kjo kërkesë është e  
8 autorizuar prej Jakup Krasniqit, dhe u pajtuat me Prokurorinë  
9 se ai e kishte kompetencën për ta bërë një gjë të tillë. A ju  
10 kujtohet kjo pjesë e dëshmisë?

11 PË. Po.

12 PY. Në pamje të parë ky dokument duket se është një kërkesë  
13 nga drejtoria për logjistikën, që i drejtohet drejtorisë së  
14 financave, dhe kërkon 1300 marka gjermane për të blerë disa  
15 objekte, disa artikuj dhe disa materiale, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Por nëse shohim dokumentin, ky nuk është i plotë si  
18 dokument, sepse në fund të faqes nuk thotë nëse kërkesa është  
19 dorëzuar apo jo. Pajtoheni?

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në fakt, të shohim në fund të  
21 faqes.

22 DËSHMITARI: Po. Dokumenti është shkruar, por në fund nuk  
23 është e rrethuar, se në fund e kemi shkresën ku thuhet "të  
24 lejohet" ose "të mos lejohet". Por nuk është rrumbullakësuar  
25 asnjëna prej tyre.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Po, pra dokumenti është i paplotë, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Më poshtë, dokumenti thotë "Eprori" dhe duket një  
5 nënshkrim këtu që duket si nënshkrimi i Jakup Krasniqit,  
6 kështu?

7 PË. Po, kështu.

8 PY. Meqë ky dokument ka datën 15 janar 1999, dhe ju na thatë  
9 se Lahi Brahimaj nuk ka qenë i pranishëm në janar të 1999,  
10 është e mundshme që Jakup Krasniqi ta ketë nënshkruar këtë  
11 dokument, por jo sepse kishte kompetencën ai për ta bërë këtë,  
12 por sepse po ndihmonte Lahi Brahimaj, i cili s' ishte i  
13 pranishëm në atë kohë. Edhe kjo është një mundësi, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. A pajtoheni me mua që shuma e parave është shumë e vogël  
16 krahasuar me nevojat financiare që ka një ushtri, apo jo?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Edhe artikujt janë gjëra shumë bazike, si orë me zile,  
19 apo jo?

20 PË. Po, është tepër bazik. Kjo është për nevoja që ka pas  
21 brenda shtabi, aty te objektet e infrastrukturës.

22 PY. Po. Do t'ju tregoj një dokument tjetër.

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] SPOE00225278.

24 PY. Ky dokument ka datën 26 dhjetor 1998, shablloni këtu  
25 është i ngjashëm me atë që sapo pamë pak më përpara, kështu?

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra (Vazhdim)

Faqe 35

1 PË. Po.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shkojmë në fundin e faqes.

3 PY. Në të njëjtën datë ku shikojmë datën, 26 dhjetor 1998,  
4 shohim një nënshkrim tjetër në fund, kështu?

5 PË. Po, saktë.

6 PY. Përbri është vula e drejtorisë së financave, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. A kam të drejtë unë, z. Zyrapi, kur them që këtë dokument  
9 mund ta nënshkruanin persona të ndryshëm në varësi të personit  
10 që ishte disponibël? Pra, ju të gjithë bashkë po përpiqeshit  
11 të ndihmonit njëri-tjetrin në kohë të vështira, kështu ka qenë  
12 situata, apo jo?

13 PË. Çdo herë në kohë të vështira ndihmohet njëri-tjetri, por  
14 këtu shifet dokumenti që është i nënshkrum nga dikush tjetër  
15 që unë nuk po e njoh këtë nënshkrim. Kërkesa është e kjartë që  
16 është bërë dhe nga kush është bë, këtë po e njof këtë person  
17 që ka pas të drejtën ta bën këtë kërkesë. Lejimin e mjeteve,  
18 lejohet nga drejtoria e financave, normalisht për, që jepen  
19 mjetet financiare për t'u blerë këto. Kështu është.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj që  
21 të pranohet ky dokument.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime. Dhe ky  
23 dokument mund të jetë një dokument publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
25 SPOE00225278 pranohet dhe riklasifikohet si publik.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti  
2 merr numrin e provës materiale 4D00075 me klasifikimin publik.

3 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

4 PY. Më 4 korrik, z. Zyrapi, ju iu përgjigjët një pyetje të z.  
5 Misetic, ku konfirmuat që ka pasur një ndarje mes  
6 përgjegjësive politike dhe atyre operative. A ju kujtohet kjo  
7 pjesë?

8 PË. Po.

9 PY. Para konferencës së paqes së Rambujesë ka pasur një  
10 periudhë goxha intensive politike, apo jo? Me veprimtari  
11 politike.

12 PË. Po.

13 PY. Më 4 korrik 1999, më falni, 2024, z. Misetic iu tregoi  
14 disa shënime nga disa takime që ishin mbajtur në janar të 1999  
15 dhe ndër këto shënime përfshiheshin qasje për të diskutuar apo  
16 për përpjekje për të diskutuar negociatat e Rambujesë në  
17 Shtabin e Përgjithshëm. A ju kujtohet?

18 PË. Po.

19 PY. Ju konfirmuat që ka qenë roli i z. Krasniqi të informonte  
20 Shtabin e Përgjithshëm për zhvillimet politike, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Roli i Jakup Krasniqit në atë kohë ishte që të merrte  
23 pjesë në takimet me përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe të  
24 informonte Shtabin e Përgjithshëm lidhur me ato që ishin  
25 diskutuar gjatë bisedimeve, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Në 2019, Pjesa 7 e intervistës suaj, faqja 5, ju thatë  
3 që:

4 "... kur i referoheshim, kur i referonim Jakup Krasniqit  
5 çështjet politike, aspektet kryesore politike nga dhjetori e  
6 në vijim, ishin aspekte, pra këto ishin aspekte që  
7 trajtoheshin nga Jakup Krasniqi."

8 PË. Po.

9 PY. A është e vërtetë që Jakup Krasniqi dhe të tjerët  
10 takoheshin me ndërkombëtarët, përfshirë Christopher Hill, dhe  
11 janë takuar me të në Dragobil më 6 nëntor të 1998?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe Jakup Krasniqi dhe të tjerë janë takuar dhe me Larry  
14 Rossin, më 22 dhjetor të 1998, apo jo?

15 PË. Nuk e di aty me kënd është taku, por e di që janë taku  
16 shpesh, edhe në Dragobil kanë pas takime me ndërkombëtarët.  
17 Tash kush ishin krejt të gjithë aty nuk kam qenë unë për të  
18 thënë se kush të gjithë kanë qenë me emrat e tyre.

19 PY. Unë po ju jap periudhën, nga nëntori deri në shkurt, këto  
20 bisedime me ndërkombëtarët kanë qenë në zhvillim e sipër,  
21 kështu?

22 PË. Po, saktë.

23 PY. Më 6 shkurt 1999, delegacioni u nis për në Rambuje,  
24 kështu?

25 PË. Për 6 shkurt, nuk e di datën saktë.

1 PY. Mirë.

2 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran P1085. Faqja  
3 27 e PDF-së. Shqipja ka të njëjtin numër të faqes, referenca  
4 është 119771 deri në 119822, faqja 27.

5 PY. Ky është pjesë e bllokut të shënimeve të Shaun Byrnes, z.  
6 Zyrapi, dhe këtu thuhet që z. Krasniqi, është emri i tretë në  
7 listë --

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbase është nevoja ta  
9 zmadhojmë pak dokumentin.

10 PY. Thotë këtu, që ai është nisur drejt Sedllarës në orën  
11 10.30 dhe është nisur pastaj drejt Parisit në orën 13.35. E  
12 shihni këtë pjesën këtu ku është ora 10 e gjysmë, 10.30, dhe  
13 13.35?

14 PË. Po.

15 PY. Është data 6 shkurt këtu.

16 PË. E shof. Po, po e shof.

17 PY. A pajtoheni me mua mes nëntorit dhe shkurtit, z. Krasniqi  
18 ka qenë kryesisht i angazhuar me çështje politike, merrej me  
19 ndërkombëtarët dhe punonte për një qëndrim të përbashkët të  
20 UÇK-së në kuadër të negociatave në Rambuje, kështu?

21 PË. Po.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga  
23 ekrani.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Alagendra, a mund t'ju  
25 bëj një pyetje? Do t'i bëj unë një pyetje lidhur me këtë.

1           Z. Zyrapi, ju sapo konfirmuat ose u pajtuat me Mbrojtjen  
2   që mes nëntorit dhe shkurtit, z. Krasniqi ka qenë kryesisht i  
3   angazhuar me çështje politike, punonte me ndërkombëtarët dhe  
4   po punonte për të përgatitur një qëndrim të përbashkët të UÇK-  
5   së. Ju e konfirmuat dhe thatë, po. Po nga e dini ju këtë? A  
6   keni qenë ju bashkë me të gjatë kësaj kohe? Gjatë gjithë kësaj  
18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Materiali 053941 deri në 053952 pranohet.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky material merr numrin  
22 4D0087 dhe klasifikimin e ka konfidencial.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I  
24 riklasifikojmë si materiale publike.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

1 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Faleminderit, z. Zyrapi. Kaq pyetje kisha.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 [Përkthim] Z. Zyrapi, tani do bëjmë pushim deri në orën

5 2.30. Faleminderit që ishit. Do rishihemi në orën 2.30.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z.

8 Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shkurtimisht. A ju kujtohet që  
10 javën e kaluar thashë që kam dy aspekte të shkurtra që duhet  
11 të trajtoj dhe do prisja derisa të përfundonte znj. Alagendra  
12 me pyetjet.

13 A mund ta bëj këtë në orën 2.30 para se të fillojë  
14 kolegu. Thashë në orën 2.00, në orën 2.30 e kisha fjalën.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
16 Në orën 2.30.

17 Seanca ndërpritet këtu.

18 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

19 --- Rifillon në orën 14.32

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,  
21 z. Emmerson. Besoj jeni gati, apo jo?

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

23 Çështja e parë ka të bëjë me një çështje praktike

24 organizimi. Besoj se e mbani mend ku po i bëja pyetje z.

25 Zyrapi lidhur me pasaportën e z. Veseli dhe ne kemi ofruar një

1 version më të mirë edhe më të freskët dhe e kemi ofruar atë si  
2 provë materiale. Megjithatë Prokurorisë i është dashur disa  
3 kohë që të krahasojë dy dokumentet edhe ka dhënë pëlqimin e  
4 saj. Domethënë që nuk është se ka kundërshtim.

5 Këtë e kemi zgjidhur bashkërisht në korrespondencën *inter*  
6 *partes* dhe në rastin në fjalë ZPS-ja nuk ka kundërshtim që kjo  
7 pasaportë ose të shtohet ose të zëvendësojë Provën Materiale  
8 të Mbrojtjes 2D18 që është dokumenti me ERN DKV0807-0814. Do i  
9 kërkoni Trupit Gjykes që në fakt ky material të mund të  
10 shtohet në provën materiale aktuale me numër prove 2D18.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk  
12 ka kundërshtime numri ERN që përmendi Emmerson do shtohet në  
13 provën 2D18.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Në këtë  
15 rast dokumenti DKV1217-1234 do të marrë numrin e provës  
16 2D00018.1.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Besoj që është versioni i  
18 rishikuar, apo jo?

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Pra, .1 do të thotë që është  
20 versioni i rishikuar besoj, apo jo?

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tema tjetër është që ka edhe një  
23 dokument tjetër që në fakt duhet t'ia kisha paraqitur  
24 dëshmitarit në mënyrë të tillë që t'i kisha bërë ca pyetje të  
25 shkurtra. Nuk besoj se do më duhen më shumë, sesa pesë ose

1 dhjetë minuta maksimumi, por dua t'ju kërkoj, të nderuar  
2 Gjykatës, që t'i bëj pyetjet lidhur me këtë dokument, duke  
3 marrë parasysh që jo vetëm që nuk i kemi tejkaluar vlerësimet  
4 tona për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por jemi më poshtë,  
5 sesa kohën që kemi përcaktuar. Kështu që do ju kërkoj të më  
6 jepnit ca minuta në dispozicion për të bërë pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
8 kundërshtim Prokuroria?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
11 Znj. Asistente, silleni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
14 Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar, e kisha të fikur mikrofonin.

15 Z. Emmerson ka thënë që ka disa pyetje të shkurtra për  
16 ju, Dëshmitar, kështu që do i japin fjalën z. Emmerson për të  
17 bërë pyetjet e tij.

18 Z. Emmerson, mund të vazhdoni.

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

20 [Vazhdim]

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. Do jenë pyetje shumë të shkurtra që kanë të bëjnë me një  
23 dokument që e keni parë edhe më herët, Dëshmitar.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është P500 numri i provës. Është  
25 materiali i cili është ngarkuar në listën e dokumenteve të

1 Prokurorisë për z. Zyrapi.

2 PY. Mban datën 14 mars dhe është letra ose deklaratë ankese  
3 nga Halil Qadraku dhe Sadik Halitjaha që përqendrohet tek ajo  
4 çfarë mendohet që të jenë mosrealizime të detyrimeve të  
5 komandimit nga komandant Drini dhe aty përmendesh edhe ti.

6 Kështu që thjesht dua që të shikojmë dokumentin te faqja  
7 e fundit.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dokumenti në shqip ka dy faqe;  
9 përkthimi në anglisht ka tri faqe, kështu që ju lutem le të  
10 shohim pak fundin e dokumentit.

11 PY. Mund ta shikoni në të djathtë besoj të dokumentit që  
12 është nënshkruar nga Sadik Halitjaha dhe Halil Qadraku. Dhe në  
13 të majtë shikohet që bëhet në tri kopje: një kopje shkon për  
14 arkivin, një kopje shkon për Shtabin e Përgjithshëm dhe një  
15 tjetër i shkon, sipas përshkrimit këtu, synohet për SHIK-un  
16 pranë Shtabit të Përgjithshëm.

17 Atëherë të ndalojmë për një çast këtu. Besoj se kam të  
18 drejtë, apo jo, Dëshmitar, ku them që pavarësisht që kjo është  
19 një letër që i është drejtuar Shtabit të Përgjithshëm, ju nuk  
20 e keni parë asnjëherë, nuk e keni marrë asnjëherë këtë  
21 dokument në ato kohë, a është e drejtë të thuhet kjo,  
22 Dëshmitar?

23 PË. Po, saktë.

24 PY. Dëshiroj që të sqaroj një aspekt të kësaj letre me ju,  
25 nëse më lejoni. Së pari, është shpjegimi ose komenti, në qoftë

1 se e keni, që kur flitet për SHIK-un pranë Shtabit të  
2 Përgjithshëm dhe duke marrë parasysh që ky është një dokument  
3 që mban datën 14 mars, domethënë, ky është sfondi për pyetjen.

4 Megjithatë, duke iu kthyer intervistës tuaj, Dëshmitar --

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dhe për procesverbal nuk është e  
6 nevojshme që të shfaqim, por për procesverbal është Pjesa 10  
7 në faqet 18 deri në 19 të intervistës.

8 PY. Ju thoni aty:

9 "Deklarohet ose thuhet këtu në fund, SHIK-ut pranë  
10 Shtabit të Përgjithshëm."

11 "PY. Pra, kjo është Shtabi i Përgjithshëm -- [Sipas  
12 përkthimit]."

13 Dhe ju përgjigjeni:

14 "SHP [Sipas përkthimit], por nuk është se ka pasur SHIK  
15 pranë Shtabit të Përgjithshëm, sepse në atë kohë ka qenë në  
16 fuqi Qeveria e Përkohshme dhe kjo ka qenë për Qeverinë e  
17 Përkohshme, jo në Shtabin e Përgjithshëm. Ka qenë drejtoria e  
18 ZKZ-së dhe shtabi, sepse kjo më pas ka ndryshuar dhe në  
19 qeverinë e përkohshme është bërë SHIK.".

20 Pra, kjo është përgjigja që keni dhënë në intervistën  
21 tuaj. Megjithatë, kemi dëgjuar disa dëshmi të tjera lidhur me  
22 këtë çështje nga z. Halitjaha. Megjithatë do ishte e saktë të  
23 përshkruhej se SHIK-u nuk e ka pas asnjëherë selinë dhe nuk ka  
24 qenë asnjëherë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, a është e  
25 vërtetë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, e vërtetë është.

2 PY. Nuk e di në qoftë se e kuptuat drejt apo jo ose  
3 gramatikisht është thënë siç duhet apo jo, por dua ta bëj  
4 kështu pyetjen: A ka kuptim për ju që me datë 14 mars z.  
5 Qadraku të ketë shkruar një dokument ku të thoshte në një prej  
6 pikave që kjo i duhet dërguar dhe SHIK-ut te Shtabi i  
7 Përgjithshëm? A ka kuptim kjo, z. Zyrapi?

8 PË. Jo, s'ka kuptim kurrfarë, po ky dokument edhe në atë kohë  
9 nuk ka ardhë as te Shtabi, lërë më te drejtorët në këtë  
10 drejtim.

11 PY. Kur ka dhënë dëshmi ai lidhur me këtë, z. Halitjaha tha  
12 se z. Qadraku ka qenë i paqartë lidhur me terminologjinë dhe  
13 ka përdorur formulime të cilat nuk është se kishin kuptim  
14 logjik, sepse nuk ka pas SHIK në Shtabin e Përgjithshëm. Po ti  
15 personalisht, a ke ndonjë njohuri në qoftë se kjo është e  
16 vërtetë, kjo që sapo thashë është e vërtetë, apo jo? Në  
17 kuptimin që z. Qadraku jo domosdoshmërisht ka qenë i njohur sa  
18 ç'duhet me Shtabin e Përgjithshëm dhe me formacionet e tij, në  
19 mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të tij?

20 PË. Po është e saktë, së pari ai s'e ka njoh as detyrën e  
21 vet. Shihet që dhe pas kësaj edhe pas luftës nuk po e njeh  
22 ende detyrën e vet, s'e ka njoh që ka pas gjatë luftës. Kështu  
23 që në Shtab nuk ka pas në atë kohë SHIK; ka qenë G2,  
24 faktikisht, drejtoria për zbulim edhe kundërzbulimit. Kurse  
25 SHIK-u është formuar tek pas -- është formuar Qeveria e

1 Përkohshme. Kështu që në atë kohë nuk ka pasur në kuadër të  
2 Shtabit fare Shërbim Informativ të Kosovës.

3 PY. Shefi i ZKZ-së në këtë kohë, domethënë më 14 mars, pra,  
4 shefi funksional i ZKZ-së brenda Shtabit të Përgjithshëm ka  
5 qenë Mensur Kasumi, apo jo, Dëshmitar?

6 PË. Mensur Kasumi në atë kohë ka qenë, ka zëvendësuar deri se  
7 nuk ka pas askush aty. Në qoftë se marrim 14 marsin, domethënë  
8 deri në atë kohë, faktikisht ka qenë Kasumi që ka zëvendësuar.  
9 Pastaj është -- ka ardhë z. Kadri Veseli edhe pak është  
10 drejtuar në atë kohë, veç kanë filluar bombardimet dhe formimi  
11 i Qeverisë së Përkohshme. Kështu që të tëra janë transferuar  
12 në Shërbimin Informativ të Kosovës, pranë Qeverisë së  
13 Përkohshme.

14 PY. Si z. Qadraku në këtë intervistë me ZPS-në, që jua citova  
15 pak më herët, dhe z. Halitjaha në dëshminë e dhënë përpara  
16 Trupit Gjykses, kanë konfirmuar se emërimet e z. Qadraku në  
17 një rol zbulim-kundërzbulimi janë bërë nga Ekrem Rexha në  
18 Shqipëri përpara se sa ai të hynte në Kosovë.

19 A keni ndonjë arsye ju për ta vënë në pikëpyetje këto  
20 deklarata që janë të vërteta, Dëshmitar?

21 PË. Po, them kështu. Pikë së pari, nuk ka mundur Ekrem Rexha  
22 t'i emërojë në Shqipëri edhe për faktikisht Halit Qadrakun  
23 edhe të tjerët se në atë kohë ala s'ka qenë edhe komandant as  
24 si emëruar, si komandant. Ai mund të ketë qetë propozimi për  
25 komandant që ka qenë. Por emërimi i tij pasi është hyrë brenda



1 në Kosovë është emëruar si komandant i zonës dhe pastaj ka  
2 vazhduar punën e vet edhe mund t'i ketë në periudhën kur ka  
3 hyrë brenda që t'i ketë emëruar për pozita të tilla. Por jo  
4 ato që thonë në Shqipëri, se nuk ka pas as të drejtën t'i  
5 emërojë as nuk ka qenë vetë z. Ekrem Rexha i emëruar si  
6 komandant i zonës.

7 PY. Ndoshta është në çështje teknikalitetesh në kuptimin që  
8 të dy kanë qenë të qartë që Ekrem Rexha e ka identifikuar z.  
9 Qadraku si personi që do të caktohej në këtë rol dhe ai më pas  
10 hyri në dhjetor. Ndërkohë që z. Qadraku ka ardhur ose është  
11 futur në javën e parë të janarit, a jeni në dijeni të kësaj,  
12 Dëshmitar?

13 PË. Po si me ardhjen në janar të z. Qadraku që atëherë e ka  
14 emëruar si zëvendëskomandant -- si udhëheqës të zbulim-  
15 kundërzbulimit në kuadër të zonës operative. Më herët unë  
16 s'di, nuk ka qenë.

17 PY. Jo, këtë doja të nxjerrja dhe unë në pah dhe për të cilën  
18 doja t'ju pyesja. Me mbërritjen e tij dhe të dy z. Qadraku dhe  
19 z. Halitjaha e kanë konfirmuar këtë. Pra, me mbërritjen e tij,  
20 pra, emërimi i tij që bëhet pak pasi ai ishte futur në Kosovë  
21 nga java e parë e janarit të dy këta persona që përmenda më  
22 sipër kanë thënë që nuk ka pasur ndonjë shërbimi zbulim-  
23 kundërzbulimi në zonën e Pashtrikut përpara, se sa të  
24 mbërrinte z. Qadraku. Domethënë, me fjalë të tjera, z. Qadraku  
25 duhet ta niste nga zero e ta formonte nga zeroja këtë shërbim

1 mbas ardhjes së tij në javën e parë të janarit. Juve si ju  
2 duket kjo; ju duket e saktë, Dëshmitar?  
3 PË. Po mund me qenë ajo, por se përpara është e vërtetë që në  
4 zonën e Pashtrikut nuk ka qenë komanda e zhvilluar para kësaj  
5 kohe se me fillimin kur është marrë kjo zonë të formohet dhe  
6 komandanti i saj i parë nuk ka arritur për shkak të sulmeve që  
7 ka pas gjatë verës nga forcat serbe; nuk ka arrit as komandën  
8 ta zhvillojë dhe kështu që është dashur që krejt të fillojë  
9 nga nëntorit, dhjetori ristrukturimi bëhet nga e para e të  
10 gjithave formimi ose ristrukturimi i një komande të zonës  
11 operative.

12 Kështu që ka mundësi edhe kjo.

13 PY. Ndërkohë që mund të ketë pasur brigada individuale ose  
14 xhepa të caktuar më shumë, me shumë të ngjarë xhepa të caktuar  
15 të ushtarëve të UÇK-së në fshatra ose qyteza të caktuara, disa  
16 prej të cilëve ishin zgjedhur ose ishin caktuar me funksion  
17 zbulim-kundërzbulimi, nuk është se ka pasur funksion në nivel  
18 zone që lidhej me zbulim-kundërzbulimin përpara janarit, a  
19 pajtoheni me këtë parashtrim timin, Dëshmitar?

20 PË. Po, unë e ceka dhe e shpjegova që më herët nuk ka pas në  
21 ato, se vetëm komanda e zonës së Pashtrikut nuk ka qenë e  
22 zhvilluar.

23 PY. Në rregull. Besoj se kam të drejtë që e konfirmuat.  
24 Megjithatë, për ta bërë 100 për qind të sigurt edhe për ta  
25 shfaqur plotësisht në procesverbal. Emërimi i Qadrakut dhe

1 hyrja e tij në rolin e shërbimit zbulim-kundërzbulimit në  
2 nivel zone është bërë një emërim nga Ekrem, është bërë emërim  
3 nga Komandant Drini, nga Ekrem Rexha, a është e saktë kjo,  
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, prej dhjetorit, janarit e tutje të gjitha janë bërë  
6 në kuadër të zonës dhe komandës së zonës janë bërë nga ana e  
7 komandantit të zonës.

8 PY. A pajtoheni me mua për pasojë se nuk ka pasur ndonjë  
9 strukturë operative ose funksionale në nivel zone në fushën e  
10 inteligjencës edhe zbulim-kundërzbulimit në zonën e  
11 Pashtrikut, përpara asaj periudhe?

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] U bë kjo pyetje dhe mori  
13 përgjigjen.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam përshtypjen nuk e përdora më  
15 përpara termin "strukturë inteligjence" për këtë arsye.

16 E kuptoj, e kuptoj që ndoshta është thjesht formulim  
17 ndryshe. Nuk kam pyetje të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
19 Prokurore, keni pyetje plotësuese?

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

21 Pyetje vijuese nga znj. Lawson:

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

24 PË. Mirëdita.

25 PY. Në verën e vitit 1998, çfarë përfshirje keni pas ju, në

1 goftë se keni pasur ndonjë përfshirje për përcaktimin ose për  
2 hartimin e politikave të UÇK-së lidhur me bashkëpunëtorët?

3 PË. Më falni, në cilën kohë? Verës 1998 apo?

4 PY. Po, po në verën e 1998.

5 PË. Jo, asgjë.

6 PY. Avokatët Mbrojtës ju sugjeruan se rrahja dhe keqtrajtimi  
7 [Sipas përkthimit] i bashkëpunëtorëve do ishte diçka e gabuar  
8 dhe ju u pajtuat me këtë parashtrim të tyrin.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për procesverbal kjo është dhënë  
10 në transkriptin në faqen T17533. Do i lutesha Sekretarit të  
11 paraqesë në ekran provën P01356 dhe të paraqisnim konkretisht  
12 faqen 6051 dhe faqen 127 në versionin shqip.

13 PY. Do t'ju lexoj një pjesë të dëshmisë tuaj, Dëshmitar, në  
14 çështjen Senovic [Sipas përkthimit]. Po lexoj nga rreshti 3 në  
15 anglisht kur të paraqitet faqja përkatëse në ekran. Pyetja që  
16 ju bëhet është kjo:

17 "A është e vërtetë që në mars [Sipas përkthimit] të 1998  
18 ka qenë njohuri e zakonshme që shqiptarët ishin -- që  
19 vriteshin, sepse ata konsideroheshin si bashkëpunëtorë?

20 "PË. Po. Në atë kohë kam dëgjuar për raste të tilla.

21 "PY. Këto raste janë përmendur gjithashtu edhe në  
22 komunikatat e nxjerra nga UÇK-ja dhe të raportuara, të botuara  
23 në gazeta kosovare, si për shembull, Koha Ditore e të tjera,  
24 është e saktë kjo?

25 "PË. Po. Në shumë raste komunikatat e Shtabeve të

1 Përgjithshme mund të gjenden gjëra të tilla siç edhe mund të  
2 gjenden dhe në artikuj gazete.”

3 Informacioni që sapo ju lexova, a është i saktë,  
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, kam dëgjuar, por jo me e dit këtë më herët, sidomos  
6 marsit 1998 kur kam qenë në Shqipëri.

7 PY. Të kalojmë në një temë tjetër. Ju bënë pyetje lidhur me  
8 faktin se si emëroheshin komandantët në zonën e Drenocit, në  
9 veçanti në qoftë se ata emëroheshin nga persona brenda  
10 përbrenda fshatrave.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është për procesverbal; kjo është  
12 thënë në TI7573.

13 PY. Për të qenë të qartë, Xhemë Gashi, për shembull, a e dini  
14 juve se si është emëruar ai; a e dini me siguri të plotë se si  
15 është emëruar ai komandant i Drenocit?

16 PË. Jo, kur kam mbërrit në Kosovë atë e kam gjet veç në  
17 pozitën e komandantit të këtij shtabi në Drenoc.

18 PY. A jeni në dijeni që ai as nuk ishte vetë nga Drenoci fare  
19 me origjinë?

20 PË. Po.

21 PY. Po Mahir Hasani, a e dini që Mahir Hasani ishte nga  
22 Drenoci fillimisht -- nuk ishte nga Drenoci fillimisht?

23 PË. Po.

24 PY. Ju bënë pyetje për mënyrën se si është emëruar Sylejman  
25 Selimi edhe ju thatë që është emëruar njësoj ose në mënyrë të

1 ngjashme si me komandantët e tjerë të zonave.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për procesverbal kjo jepet në  
3 faqen e transkriptit T17569 [Sipas përkthimit].

4 PY. Dua t'ju lexoj një pjesë të shkurtër të dëshmisë që ka  
5 dhënë Sylejman Selimi para TPNJ-së.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca për këtë është IT-03-  
7 666 T224 [Sipas përkthimit] në faqen 2212. Për këtë është në  
8 dispozicion vetëm versionin në anglisht, kështu që do jua  
9 lexoj.

10 PY. Gjykatësi e pyet:

11 "Kush ishte komandant i zonës së Drenicës nga mesi i  
12 majit të vitit 1998?

13 "PË. Doni të thoni i policisë ushtarake?

14 "Gjykatësi: Jo, i zonës së Drenicës së UÇK-së.

15 "PË. Për mesin e marsit e keni fjalën.

16 "Gjykatësi: Jo, e kam fjalën për mesin e majit të 1998.

17 "PË. Unë u emërova nga Shtabi i Përgjithshëm si komandant  
18 i zonës së Drenicës."

19 A është në pajtim me atë çfarë dinit ju lidhur me këtë  
20 person, Dëshmitar?

21 PË. Jo, nuk e di qysh është emëruar më herët edhe kush e ka  
22 emëruar, atë nuk e di. Kur kam shkuar e kam gjet në pozitën e  
23 komandantit të zonës. Faktikisht nënzonat kanë qenë në atë  
24 kohë.

25 PY. Në rregull. Ju nuk e dini se si është emëruar ai në atë

1 pozicion; këtë po thoni, Dëshmitar?

2 PË. Po, qartë.

3 PY. T'i kthehemi kohës kur keni mbërritur për herë të parë në  
4 Likoc.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarisë  
6 që të paraqesë në ekran provën P00606. Mund të qëndrojmë te  
7 faqja e parë në anglisht dhe në versionin në shqip teksti që  
8 është për interes për neve është në fund fare në të majtë të  
9 faqes së fundit.

10 PY. Është intervista që ju i keni dhënë gazetës Zëri,  
11 Dëshmitar.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ta kalojmë pak nga ana tjetër,  
13 sepse është në të majtë, në fund të majtë te faqja në shqip.

14 PY. Do t'jua lexoj tani, z. Zyrapi. Pyetja që ju bëhet është  
15 kjo:

16 "Domethënë ende pa hyrë në Kosovë ju përfaqësohet e keni  
17 ditur funksionimin dhe detyruat ushtarake që do t'i mbartnit!"

18 Ju përgjigjeni si më poshtë:

19 "Po. Përfaqësohet kështu ka qenë. Pra, më është thënë se  
20 unë do të jem përgjegjës për eprrorët brenda dhe jashtë vendit.

21 Në atë kohë mund të them se isha vetëm në cilësinë e  
22 koordinatorit. Pas tri ditësh qëndrimi në Drenoc komplet grupi  
23 i eprrorëve shkua në Drenicë e më konkretisht në Likoc. Në  
24 Likoc, Hashim Thaçi më dha urdhër që t'i përgatis eprrorët dhe  
25 t'i shpërndajmë ata nëpër zonat e luftës, detyrë të cilën e

1 kisha biseduar më parë se nga mund të shkojë secili prej tyre.  
2 Atëherë e kemi bërë planin e shpërndarjes dhe unë vendosa si  
3 më poshtë që:

4 "Kadri Kastrati, 'Daja i Llapit' të shkonte në Llap. Aty  
5 u takova edhe me Rrustem Mustafën, 'Remi', me nofkën 'Remi' i  
6 cili ishte koordinator për këtë zonë, domethënë për zonën e  
7 Llapit.

8 "Vendosa që Mensur Kasumi të shkonte në Mitrovicë..." dhe  
9 pastaj vazhdoni më tej për të shpjeguar se cilat kanë qenë  
10 emërimet e tjera.

11 A është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

12 PË. Po, unë kam marrë pjesë në të, domethënë, se është pyetur  
13 për mua për eprorë çdo herë. Mirëpo, shkuarja e këtyre kur  
14 kemi mbërrit në Likoc komandantët të zonave vetë kanë qenë  
15 vetë atje, kanë ardhur dhe i kanë kërkuar këta persona, për  
16 shembull, zona e Remit, e Llapit, Remi ka kërkuar që Kadri  
17 Kastrati të shkonte në Llap, ç'ka janë pajtuar në atë drejtim;  
18 kurse te zona e Shalës, Rrahman Rama ka kërkuar që të shkojë  
19 Mensur Kasumi edhe Hysni Ahemti.

20 Kështu që janë pajtuar në atë drejtim. Po, unë faktikisht  
21 njëfarë lloj koordinatori kam qenë për eprorët brenda dhe  
22 jashtë që janë. Faktikisht brenda me ta që kemi hy dhe jashtë  
23 që kanë qenë.

24 PY. Të martën e javës së shkuar avokati i z. Veseli ju bëri  
25 pyetje lidhur me një takim që keni pasur me Ramush Haradinajn



1 ku ai kërkonte shpjegime lidhur me emërimin e Jakup Krasniqit  
2 si zëdhënës, a ju kujtohet pyetja, Dëshmitar?

3 PË. Po, më kujtohet pyetja.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të  
5 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00225800.

6 PY. Atëherë pyetja e parë që kam për ju, Dëshmitar, është, a  
7 e njihni nënshkrimin këtu?

8 PË. Po.

9 PY. Ky është dokumenti i cili mban datën 2 korrik 1998. Mund  
10 të shohim që edhe pika e dytë kërkohen sqarime lidhur me  
11 emërimin e Jakup Krasniqit si zëdhënës. Mbështetur në dëshminë  
12 e dhënë javën e shkuar, ky emërim, pra, emërimi i Jakup  
13 Krasniqit si zëdhënës ishte një çështje për të cilën kishte  
14 ngritur shqetësime Ramush Haradinaj dhe me të cilin ju dhe  
15 Kadri Veseli u takuat me Ramushin në qershor, a është kështu,  
16 Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Në të njëjtën pikë shohim që kërkohet një kopje e  
19 rregullores. Te pika e parë, Ramush Haradinaj kërkon sqarime  
20 për terminologjinë, pra, sqarim mes Shtabit të Përgjithshëm  
21 dhe Shtabit Qendror. A ka qenë edhe kjo një nga gjërat që  
22 është diskutuar gjatë takimit apo jo?

23 PË. Normalisht çdo send nuk më kujtohet të gjithë, por, po,  
24 po kanë qenë pikërisht këto, disa pika që janë diskutuar aty.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim materialin SPOE00225067.

1 PY. Kur të dalë në ekran do e shihni që është një dokument i  
2 papërfunduar, në fakt ka disa shënime. Por thotë që është në  
3 përgjigje të një kërkesë që është dorëzuar me shkrim, të  
4 parashtuar me shkrim. Shohim pikën 3 dhe këtu trajtohet  
5 çështja e Shtabit të Përgjithshëm përkundrejt Shtabit Qendror.  
6 Te pika 4 thuhet: Rregulloren e përkohshme për organizimin e  
7 jetës së brendshme të ushtrisë, po jua dërgojmë. Te pika 5 jep  
8 informacione lidhur me zëdhënësin. Kjo është në përgjigje të  
9 kërkesës që sapo pamë më përpara.

10 Pra, ky dokument duket se është një dokument në përgjigje  
11 të kërkesave që kishte parashtuar Ramush Haradinaj, tek ai  
12 dokumenti që pamë pak më herët. A pajtoheni me mua?

13 PË. Po.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj  
15 pranimin e të dy dokumenteve SPOE00225800 dhe dokumenti që  
16 është aktualisht në ekran.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka  
18 kundërshtime?

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dëshmitari nuk është autori i  
20 këtij dokumenti, kështu që unë e kundërshtoj. Dhe ky është --  
21 kemi dhe kundërshtimin e përhershëm sa i takon mënyrës së  
22 sekuestrimit të materialeve.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi  
24 rrëzohet.

25 Materiali SPOE00225800 dhe SPOE00225067 pranohen.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga znj. Lawson

Faqe 115

1           SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
2 dokumenti i parë me numër SPOE00225800 deri SPOE00225800 dhe  
3 përkthimi në gjuhën angleze marrin numrin e provës materiale  
4 P1446 dhe aktualisht kanë klasifikimin konfidencial.

5           Dokumenti i dytë që ka numrin SPOE00225067 deri në  
6 SPOE00225068 dhe përkthimi në gjuhën angleze do të marrë  
7 numrin e provës materiale P01447 dhe është i klasifikuar si  
8 konfidencial.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të  
10 riklasifikohen të dy dokumentet si dokumente publike.

11          SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

12          ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

13 PY. Dëshmitar, kërkesa nga Ramush Haradinaj drejtuar Shtabit  
14 të Përgjithshëm që sapo pamë, ju ishit në dijeni të këtyre  
15 pikave, sepse ai i kishte ngritur këto gjatë takimit, por a  
16 kam të drejtë unë kur them që ju me shkrim këtë kërkesë nuk e  
17 kishit parë më përpara?

18 PË. Jo, nuk e kam parë asnjëherë këtë shkresë dhe normalisht  
19 që s'kam marrë pjesë në ndërtimin e kësaj shkrese për arsye se  
20 unë në atë kohë ende kam qenë oficer për zhvillimin e për [E  
21 pakuptueshme] në kuadër të drejtorisë operative.

22 PY. Dhe kjo është pothuajse e njëjta gjë që keni thënë kur ju  
23 kanë treguar këtë dokument gjatë seancës përgatitore. Ju keni  
24 thënë që në atë kohë keni qenë oficer për zhvillim në kuadër  
25 të drejtorisë operative dhe nuk ishit i përshirë në interesime

1 apo aktivitete të Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Kur iu përgjigjët pyetjes lidhur me shpeshtësinë e  
4 kontakteve mes Shtabit të Përgjithshëm dhe zonave apo njësive  
5 për periudhën maj deri në shtator 1998 - për procesverbal  
6 është dokumenti T17870 -, ju jeni përgjigjur vetëm për  
7 kontaktet që keni pasur ju vetë?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Është pyetje  
9 sugjestionuese.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

11 PY. Edhe një herë. Atëherë, Dëshmitar, cila ishte baza juaj -  
12 -

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
14 Është në fakt pyetje sugjestionuese. Ju lutem,  
15 riformulojeni.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

17 PY. Do t'ju pyes edhe një herë: Mbi ç'baza e përshkruat ju  
18 shpeshtësinë e kontakteve mes Shtabit të Përgjithshëm dhe  
19 njësive apo zonave nga maji deri në shtator 1998?

20 PË. Ata kur e kanë shpjeguar e kanë shpjeguar veç për vete.

21 Personalisht unë kur kam qenë edhe me kë kam pas kontakte; jo  
22 me Shtabin e Përgjithshëm në përgjithësi për takimet e  
23 shpeshta.

24 PY. Pra, ne kemi parë në fakt edhe dokumente të tjera ku  
25 tregonin se ka pasur kontakte për të cilat ju nuk keni pasur

1 dijeni në verën e 1998?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Ju kanë bërë pyetje edhe për operacionet, qëndrojmë në  
4 verën e 1998.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kjo është në transkriptin 17879.

6 PY. Ju lexuan edhe një pjesë të dëshmisë së mëhershme që  
7 kishit dhënë ju, por nuk ju lexuan sqarimin që keni bërë gjatë  
8 seancës përgatitore. Ju keni pyetur për periudhën maj-shtator  
9 1998. Dua të jem e sigurt që e kemi të qartë periudhën kohore  
10 dhe çfarë dini e çfarë nuk dini. Do t'ju lexoj sqarimin.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është në Shënimin Përgatitor  
12 numër 2, paragrafi 29.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Është sugjestionuese;  
14 nuk lejohet që të lexojë paragrafin përkatës. Të bëjë pyetjen  
15 siç duhet nëse do të diskretitoje dëshmitarin.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk është kjo qëllimi im.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
18 kundërshtimi.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

20 PY. "Dëshmitari ka sqaruar se në maj --

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Me sa kuptova unë ju nuk e pranuat  
22 kundërshtimin; ju e pranuat kundërshtimin.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po pyetja  
24 është sugjestionuese. Nuk lejohet.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislrim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga znj. Lawson

Faqe 118

1 PY. Z. Zyrapi, gjatë majit e shtatorit të 1998, a mund t'i  
2 përshkruani Trupit Gjykses se në cilën periudhë kohore keni  
3 pasur dijeni konkrete se si organizoheshin operacionet nga  
4 Shtabi i Përgjithshëm, në qoftë se keni ndonjë dijeni?

5 PË. Në atë periudhën çka e di unë dhe çfarë kam mundur me  
6 parë, që në asnjëherë nuk kam has në ato që Shtabi i  
7 Përgjithshëm ka përgatitur operacionet në përgjithësi në  
8 Kosovë se nuk ka pas edhe mundësinë edhe si zhvillimi i  
9 drejtorisë, por edhe njerëz që kanë punuar më herët nuk e di,  
10 nuk kam pas dijeni në ato që kanë bërë, diçka ndonjë plan të  
11 tillë ose që kanë mund t'i organizojnë operacionet në Kosovë.

12 PY. Përgjigja juaj ishte e bazuar në atë çka keni vrojtuar ju  
13 personalisht, apo jo? E çfarë keni pasur dijeni, kështu?

14 PË. Personalisht kur foli çdoherë foli në atë çka di unë edhe  
15 unë çfarë kam marrë pjesë dhe ku kam qenë. Edhe atëherë.  
16 Normalisht unë çka di dhe çka kam mundur me vërejt.

17 PY. Ju bënë pyetje për luftimet gjatë ofensivave edhe luftën  
18 në Grykën e Llapushnikut.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim materialin 1D00102810-AT  
20 [Sipas përkthimit] AT dhe ET, anglisht edhe shqip, pra. Faqja  
21 është faqja që përfundon me 2984. Paragrafi i parë në faqe.

22 PY. Edhe për t'ju informuar që dokumenti që do të shohim  
23 është intervista që keni dhënë ju për gazetën *Zëri*. Tek  
24 paragrafi i parë përshkruani luftimet, thoni:

25 "Shkova në Bllacë dhe pashë që forcat tona po luftonin në

1 vijën e frontit. Në mëngjes luftimet filluan në Grykën e  
2 Llapushnikut ku ishte vendosur vija e parë e frontit. Unë dhe  
3 Luli shkuam nga Shtabi Qendror dhe pozicionuam disa forca për  
4 të ndihmuar Llapushnikun. Filluam koordinimin e njësisve, ku  
5 një njësi armike nga Banjica sulmoi forcat tona nga mbrapa. Në  
6 të njëjtën kohë filluan gjithashtu luftimet drejt Kijevës dhe  
7 unë u largova nga Gryka e Llapushnikut për të shkuar drejt  
8 Kijevës dhe Ujëmirit.”

9 Ky informacion është i saktë?

10 PË. Po.

11 PY. Në këtë kontekst kush është Luli?

12 PË. Kadri Veseli.

13 PY. Ju gjithashtu keni shpjeguar në dëshminë tuaj se si gjatë  
14 ofensivës ju personalisht, por edhe anëtarë të tjerë të  
15 Shtabit të Përgjithshëm keni qenë shumë të përfshirë në  
16 luftime dhe keni organizuar mbrojtjen. Dhe pamë dhe një  
17 shembull konkret të kësaj.

18 Po Jakup Krasniqi ka marrë pjesë në luftime apo ka  
19 ndihmuar për organizimin e mbrojtjes në vijën e frontit, në  
20 vijat e frontit?

21 PË. Jo, nuk ka qenë aty. Ai ka qenë në zyrë.

22 PY. Pra, ai udhëtonte më pak se anëtarët e tjerë të Shtabit  
23 të Përgjithshëm gjatë kësaj periudhe kohore?

24 PË. Po. Më shumë ne si më të rinj kemi qenë dhe kemi mund me  
25 lëviz më shpesh dhe kemi shkuar nëpër zona dhe sidomos gjatë

1 luftimeve në 1998 edhe një pjesë e Shtabit e ndarë pjesë e  
2 pjesë duke shkuar nëpër zona për t'i ndihmuar atyre.

3 PY. Ai njihej publikisht në atë kohë si zëdhënës, apo jo?

4 PË. Po, saktë.

5 PY. Pra, kur keni thënë në Pjesën 2, faqja 24 e intervistës  
6 suaj për ZPS-në se në atë kohë mënyra se si ishte e organizuar  
7 ishte e atillë që komandantët e zonave informonin zëdhënësin  
8 për përfundimin e operacioneve, këtë kishit në mendje ju që ai  
9 ishte më i lehtë të gjendej dhe të kontaktohej, përshirë edhe  
10 korrierët; e kishit më lehtë të kontaktonit atë?

11 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Sugjestionuese.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
13 kundërshtimi.

14 DËSHMITARI: Po, në atë kohë më lehtë ka qenë për shkak të  
15 lëvizjeve tona nëpër zona dhe s'kanë mundur më shpesh të  
16 merren me neve. Në disa zona nuk kemi qenë, për shembull.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] T'i kthehemi dokumentit në ekran.  
18 Shohim paragrafin e fundit në të njëjtën faqe.

19 PY. Ju lutem, lexojeni vetë pa zë paragrafin. Është kjo që  
20 fillon: "Kur filluan luftimet në Drenicë...", lexojeni me  
21 mendje dhe kur të përfundoni na thoni.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju lutem Sekretarit ta nxjerrë të  
23 plotë faqen, ju lutem, në ekran, që të kemi mundësi ta shohim.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, kur të jeni gati, unë fillimisht do doja t'ju



1 pyesja --

2 PË. Gati.

3 PY. -- a është e saktë kjo? Pra, a është përshkruar saktë  
4 ngjarja në këtë paragraf, situata?

5 PË. Po, e kam përshkruar përafërsisht ato situata që kanë  
6 ndodhur, saktë qysh e kam perceptuar, q'ashtu ka shkuar, ka  
7 ndodhur.

8 PY. Në këtë kontekst, kush janë Luli dhe Rexha?

9 PË. Rexha është Rexhep Selimi.

10 PY. Po Luli?

11 PË. Luli është Kadri Veseli.

12 PY. Çfarë ndërtesash ka përdorur UÇK-ja në Likoc në verën e  
13 1998?

14 PË. Në Likoc ka përdorur objektin ku ka qenë, më duket se ka  
15 qenë përpara kooperative, s'di çka, aty ka qenë komanda e  
16 zonës operative e Drenicës, por edhe shpesh edhe Shtabi është  
17 takuar aty. Dhe domethënë, ka qenë. Ky është objekti, edhe sot  
18 ekziston aty në Likoc, për atë objekt është puna -- është  
19 fjala.

20 PY. Do ndryshoj pak temë. Një nga avokatët mbrojtës që tregoi  
21 një incizim, video, nga qershori 1998, ju flisni në atë video  
22 dhe shpjegoni se si anëtarët e UÇK-së po mësonin shumë shpejt.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran  
24 materialin P00605. Shkojmë te faqja e tretë tek anglishtja;  
25 shqipja është paragrafi i dytë te kolona e tretë e tekstit.

1 PY. Ju kanë bërë këtë pyetje:

2 "A keni vërejtur ngjashmëri në mes të luftës në Bosnje  
3 dhe kësaj në Kosovë?"

4 Ju jeni përgjigjur kështu:

5 "Po. Kishte mjaft ngjashmëri. Edhe në Bosnje fillimi i  
6 luftës ishte i njëjtë, sidomos sa i përket fillimit të luftës  
7 dhe të strukturimit ushtarak. Ngjashmëria ka qenë e madhe, por  
8 sa i përket zhvillimit të fazave të këto faza janë  
9 zhvilluar më shpejt, sesa në Bosnje. Për shembull, atje është  
10 dashur që të kalojë një kohë e gjatë që të formohen zonat apo  
11 korpuset; kurse të këto janë zhvilluar shumë shpejt."

12 Kjo pjesë që sapo lexova është e vërtetë kur keni thënë  
13 që ushtarët e UÇK-së po mësonin shpejt?

14 PË. Po. Është e vërtetë që kam thënë që mësojnë shpejt, por  
15 formimet është më shpejt për arsye se në qoftë se marrim  
16 krahasuar Bosnjën edhe Kosovën është më shpejt, se të ne veç  
17 kur kam ardhur ata kanë qenë në zona sado kudo që kanë fillu  
18 të punohen edhe të formohen. Kurse në Bosnje nuk ka qenë në  
19 fillim të tilla, për atë janë edhe më shpejt të ne them pak më  
20 shpejt janë zhvilluar se atje. Është e vërtetë që kanë mësuar  
21 më shpejt shumica, duke marrë parasysh që shumica e tyre, do  
22 të thotë jo 80 për qind por edhe 90 për qind nuk ka ditur, nuk  
23 kanë pas shërbimet ushtarake as me dit në aspektet ushtarake  
24 si edhe përdorimin e armës dhe aspektet taktike. Dhe kanë  
25 mundur më shpejt të marrin këtë njohuri, sesa, për shembull,

1 në Bosnje të cilës [E pakuptueshme] kanë pas 90 për qind të  
2 cilët kanë qenë të shërbimit ushtarak dikur i kanë kryer edhe  
3 kanë qenë më të aftë edhe më të përgatitur. Por më shpejt kanë  
4 mësuar tanët më të rinj të cilët në atë kohë kam mundur ta  
5 vërej dallimin mes Bosnjës dhe ne. Kjo ishte në këtë kontekst.  
6 PY. A mund të shpjegoni, nga këndvështrimi ushtarak çfarë  
7 përfitimi ka një komandant që të ketë nivele të ndërmjetme  
8 komande mes tij edhe njësive në terren. Pra, mes komandantëve  
9 dhe njësive në terren të ketë dhe një nivel të ndërmjetëm;  
10 çfarë përfitimi sjell kjo?

11 PË. Në cilin aspekt përfitime? Se në aspekte komanduese,  
12 ushtarake është aspekti profesional në të cilën vendosen në  
13 pozitën komanduese dhe kanë autoritetet. Në qoftë se marrim  
14 çlirimin tonë -- ushtrinë tonë që është formuar nga zero është  
15 më shumë lidh bazohet në autoritete, jo në aspekte  
16 profesionale shumë. Domethënë, autoritetin që e ka ai,  
17 domethënë e ka dhe mund të udhëheqë dhe komandojë me atë  
18 njësitë të cilët i ka në zonën ku ai është i përcaktuar si  
19 komandant. Në qoftë se mendoni në këtë aspekt ku e kërkon  
20 pyetjen.

21 PY. Më shumë isha e interesuar të dija për një komandant që  
22 ka shumë njësi në terren, si e ndihmon kjo një komandant kur  
23 ka dhe linja të ndërmjetme, linja të ndërmjetme komandimi mes  
24 komandantit edhe njësive në terren; si i shërben kjo  
25 komandantit?

1 PË. Po lidhje të ndërmjetme janë në qoftë se marrim, për  
2 shembull, komandantin e zonës, ai ka komandantët e brigadave  
3 të cilat e ndihmojnë komandantin e zonës; komandantët e  
4 brigadës i kanë komandantët e batalioneve, këta janë  
5 ndërmjetësues në mes komandantit dhe njësisë më poshtë.  
6 Domethënë, janë udhëheqësit ose komandantët të cilët janë ndër  
7 to, ndër atë komandë, ndër atë komandant, ndër atë zonë.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem, shohim materialin  
9 P00605. Faqja 1 në anglisht; në shqip është në krye të kolonës  
10 së parë.

11 PY. Ju keni thënë:

12 "Kemi ditur mirë që ne eprorëve na pret një punë e madhe,  
13 një angazhim më tepër se normal, por ne nuk ngurruam asnjëherë  
14 t'i kryenim këto detyra për të bërë ristrukturimin e ushtrisë  
15 dhe vendosjen e hierarkisë ushtarake në njësitet e UÇK-së prej  
16 lart poshtë. Sepse në ushtri nuk ka udhëheqje horizontale, por  
17 gjithçka shkon vertikalisht. Edhe pse mund të them se Shtabi i  
18 Përgjithshëm i UÇK-së në atë kohë e kishte kontrollin e të  
19 gjitha njësiteve të saj, por në mënyrë si Shtabi deri atëherë  
20 ka ushtruar kontrollin ka qenë ngarkesë e madhe për të. Me  
21 shkuarjen tonë atje filloi të lehtësohej puna."

22 Kjo pjesë është kjo që keni dashur të thoni ju? Vendosja  
23 e këtyre linjave të ndërmjetme, sepse duke pasur një strukturë  
24 të ndërmjetme ushtarake e bënte më të lehtë Shtabin e  
25 Përgjithshëm të ushtronte autoritetin e vet?

1 PË. Po, është e saktë ajo që kështu që për çdo ushtri për ta  
2 pas më të lehtë me komanduar me njësitë i kanë këto pjesë  
3 ndërmjetëse ose ristrukturimi që shkon nga lart poshtë.  
4 Domethënë, në qoftë se marrim, Shtabi i Përgjithshëm e ka  
5 komandën e zonës që e lehtëson punën e veprimit me njësinë më  
6 poshtë; komanda e zonës ka komandat e brigadave që lehtësojnë  
7 veprimin e saj të punës me njësi më poshtë dhe brigadat më  
8 poshtë batalionet e më poshtë shkojnë kompanitë edhe togjet e  
9 deri te skuadrat. Për këtë janë ndërmjetësuese dhe kur të  
10 bëhet riorganizimi në këtë kontekst është folur dhe është  
11 thënë.

12 PY. Tani do të ndryshoj temë. Do t'ju lexoj një pjesë të  
13 intervistës që keni dhënë për ZPS-në.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është Pjesa 2, faqja 8. Edhe kjo  
15 lidhet me pjesën e transkriptit 17904.

16 PY. Pyetja ka qenë kjo:

17 "A ka qenë ky takimi jua i parë me Rexhep Selimin?

18 "PË. Po.

19 "PY. Dhe sipas teje çfarë roli kishte ai? Si ta shpjegoi  
20 rolin e tij?

21 "PË. Si Rexhep Selimi dhe Sokol Bashota u prezantuan si  
22 pjesë të drejtorisë operative dhe se unë do të punoja me ta.

23 "PY. Në rregull. Dhe mënyra se si e kuptova -- jo do jua  
24 bëj edhe një herë pyetjen, sipas teje kush ishte komandanti  
25 operativ asokohe?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese nga znj. Lawson

Faqe 126

1 "PË. Në atë kohë unë mendova se ishte Rexha -- Rexhepi."

2 Kjo ju është lexuar ju gjatë kundërpyetjeve nga një  
3 avokat mbrojtës. Dhe ju e konfirmuat në fakt që roli i tij në  
4 fakt s'ishte roli i një komandanti. Por do t'ju lexoj edhe një  
5 pjesë të dëshmisë që keni dhënë në gjykimin Limaj, sepse do na  
6 ndihmojë që ta sqarojmë këtë pjesë.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca është IT-03-66 T6757.  
8 Shqipja është IT-03-66 T6818.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë në fakt mbase duhet të prisja  
10 që të bëhej pyetja, por kjo pjesa e transkriptit që po përdor  
11 Prokurorja nuk është pjesë e provave gjyqësore dhe kam frikë  
12 se mos bën ndonjë pyetje sugjestionuese Prokurorja dhe do jetë  
13 tepër vonë për mua që të çohem dhe të bëj kundërshtimin tim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
15 përgjigjeni?

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë po përdor pyetjet që janë  
17 bërë gjatë kundërpyetjeve. Po bazohem te kundërpyetjet, kështu  
18 që po bëj pyetje plotësuese bazuar në pyetjet që kanë përdor  
19 avokatët mbrojtës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
21 kundërshtimi.

22 Prokurorja mund të vazhdojë.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tek anglishtja nevojitet faqja  
24 6826. Shqipja faqja 10 dhe kalon poshtë te faqja 11.

25 PY. Ju keni thënë kështu:

1 "Atje ku më çoi drejtorja operative që në atë kohë  
2 drejtohej nga Rexhep Selimi për të ndihmuar me organizimin e  
3 njësisë në Kleçkë dhe kisha detyrë që t'u tregoja atyre se si  
4 të punonin dhe t'i ndihmoja. Ishte një shtëpi mes Kleçkës dhe  
5 Divjakës që po përgatitej".

6 Dhe pastaj vazhdon me pjesën tjetër të dëshmisë.

7 PY. Pra, pikë së pari kjo që unë ju lexova, a është e saktë?

8 PË. Po, në atë kohë, së pari kam, faktikisht ka qenë Sokol  
9 Bashota drejtori i operativës po edhe z. Selimi kanë qenë  
10 bashkë në këtë drejtori operative. Kështu që ka mund me qenë  
11 edhe gjatë edhe fjalimit dhe përkthimit që të thuhet dhe njoni  
12 dhe tjetri. Por faktikisht të dy kanë qenë në këtë drejtori  
13 dhe që kanë punuar; me ta kam punuar edhe unë, pasi kam hyrë  
14 brenda në Kosovë. Kështu që nga aspekti im unë e di që z.  
15 Sokol Bashota siç më është komentuar prej tij që ai është  
16 kryesori i drejtorisë operative.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të  
18 paraqesë në ekran dokumentin P00778.

19 A nuk e di në qoftë se doni që të bëjmë ndonjë pushim  
20 tani apo është ora 15.30.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dua të bëj një korrigjim për  
22 transkriptin se thuhet se Sokol Dobruna, besoj që duhet të  
23 jetë Sokol Bashota. Për procesverbal, domethënë, e kam këtë.  
24 Është në rreshtin 21. Mendoj që duhet të korrigjohet kjo. Në  
25 rreshtin 21, faqja 110.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kryegjykatës, në këtë pikë  
3 dëshiroj gjithashtu që të bëj një kundërshtim. Prova P00778  
4 është pjesa A. Kjo është një çështje e cila është trajtuar nga  
5 Trupi Gjykes në faqen e transkriptit 1440 dhe pastaj është  
6 dhënë një urdhër me gojë sa i takon shtimit të dokumenteve në  
7 listën e dokumenteve që janë liruar ose janë shënuar për  
8 palët.

9 Nuk është marrë leje lidhur me këtë dokument që për këtë  
10 arsye neve kundërshtojmë pranimin dhe përdorimin e këtyre  
11 dokumenteve.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është  
13 përgjigja juaj?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto janë  
15 dokumente të cilat janë përdorur në kundërpjetje dhe në fakt  
16 kjo është praktika që është përdorur deri tani.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, përsëri nuk e di  
18 se çfarë praktike, për çfarë praktike e ka fjalën Prokurorja,  
19 por nuk mbaj mend që të jetë përdorur ndonjë praktikë e tillë  
20 deri tani.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
22 Do t'jua lëmë në dorë që ta diskutoni ndërmjet palëve këtë  
23 çështje.

24 Z. Zyrapi, do bëjmë 10 minuta pushim dhe pastaj do  
25 punojmë deri në fund të ditës përsëri.



1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
3 pushim për dhjetë minuta tani.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 15.32

5 --- Seanca rifillon në orën 15.42

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë cili  
7 ishte rezultati i komunikimit ndërmjet palëve?

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne i dhamë  
9 avokatit disa emra të dëshmitarëve. Gjithashtu i kemi dhënë  
10 edhe referencën e një vendimi të marrë që mund të gjendet në  
11 faqen e transkriptit 10353 deri në 55.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, i nderuar Kryegjykatës. Ka një  
13 rast kur z. -- ku kundërshtimi i z. Kehoe u rrëzua po nuk u  
14 dha asnjë shpjegim lidhur me të. Kështu që unë do të  
15 parashtroja që vendimi nuk është se është rregulluar kjo  
16 çështje nga një urdhër i dhënë nga Trupi Gjykses.

17 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në përgjithësi  
18 Prokurori ose Prokuroria është e lirë që të bëjë pyetje për  
19 dokumente të cilat janë trajtuar në kundërpjetjet tuaja dhe  
20 mesa kuptova ka qenë dokument i cili ka qenë në listën e  
21 dokumenteve të Prokurorisë, apo jo?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Sapo u shtua aty.

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po janë pyetje  
24 e plotësuese.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, është e saktë.

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë po e  
2 rregulloj këtë çështje duke thënë që mbështetur në njohurinë e  
3 përgjithshme kjo është diçka të cilën -- për të cilën  
4 Prokuroria mund të bëjë pyetje.

5 Në rregull. Mund ta sillni dëshmitarin në sallë tani.

6 [Mikrofoni çaktivizuar].

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mbase do të jem edhe ca kohë.

8 PËRKTHYESJA: Më falni, Gjykatësi e kishte mikrofonin e  
9 fikur.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë kemi  
12 45 minutat e fundit për ditën e sotme, z. Zyrapi. Bsoj se do  
13 ju kënaqte një informacion i tillë.

14 Tani do të vazhdojmë më tej me pyetjet e Prokurorisë për  
15 juve.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. I lutem Sekretarit  
17 të paraqesë në ekran provën P00778, konkretisht kërkoj të  
18 paraqitet në ekran faqja P6595. Është dokument që nuk ka  
19 përkthim në shqip kështu që do e lexojmë.

20 PY. Është dëshmi e dhënë nga Rexhep Selimi përpara TPNJ-së.  
21 Atij i bëhet pyetja:

22 "Çfarë pozicioni keni pasur ju gjatë këtyre muajve, mars,  
23 prill, maj 1998?

24 "PË. Deri në maj 1998 kur ka pasur një shtab qendror të  
25 UÇK-së nuk ka pasur një përcaktim të detyrave, por të gjithë

1 personat që kanë qenë pjesë e këtij shtabi kanë qenë anëtarë  
2 të shtabit pa një përcaktim të qartë të detyrave dhe  
3 përgjegjësive të tyre. Pas majit të 1998-s dhe pas  
4 ristrukturimit të shtabit të Drenicës, unë u bëra shef i  
5 operacioneve i UÇK-së në G3."

6 Ky përshkrim i dhënë nga z. Selimi, që ai ka luajtur atë  
7 rol, a është në pajtim me atë çfarë ju i keni ZPS-së që keni  
8 kuptuar që është roli i atij në atë kohë? A është e saktë kjo,  
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, që është në drejtori operative ka qenë.

11 PY. Në dëshminë e dhënë përpara një jave e bëtë të qartë që  
12 edhe në korrik 1998 pasi ishit caktuar shef i drejtorisë  
13 operative, ju nuk e dinit plotësisht se si ishte -- se çfarë  
14 strukture kishte Shtabi i Përgjithshëm. Dhe thatë që deri në  
15 nëntor ju nuk është se kishit një informacion të plotë lidhur  
16 me këtë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për të qenë më e saktë, kjo është  
18 dhënë në faqen e transkriptit T17905.

19 PY. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 PY. Në fakt, javën e shkuar keni konfirmuar në 18031, dhe  
22 mendoj që e përsëritët edhe sot paradite, që edhe pse kishe  
23 disa role që ishin caktuar më përpara, deri në nëntor 1998,  
24 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm bënë ç'mundeshin në mënyrë  
25 të tillë që të kontribuonin pa pasur një ndarje të rreptë të

1 roleve dhe përgjegjësi të tyre. A është e saktë kjo,

2 Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. Dëshmia përpara këtij Trupi Gjykses, po gjithashtu edhe  
5 dëshmia në deklarata të mëhershme ka qenë që drejtorja e  
6 inteligjencës ka ekzistuar përpara nëntorit 1998, por a e kam  
7 drejtë, ose e kam kuptuar drejtë që ju nuk e dinit se kush ka  
8 qenë përgjegjës për atë ose si ka qenë e strukturuar kjo  
9 drejtori atëherë?

10 PË. Si ka qenë e strukturuar nuk e kam dit.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të  
12 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00052989, që është versioni  
13 në shqip ky dhe SPOE00052992, versioni në anglisht i të  
14 njëjtit dokumenti. Kjo është një intervistë e dhënë nga Kadri  
15 Veseli për Baton Haxhiun. Do i kërkoja Sekretarit që në të  
16 dyja dokumentet të shkonit në faqen që përfundon me 53011.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, a mund të më  
18 jepni edhe një herë referencën e dokumentit në anglisht?

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. SPOE00052992. Ju lutem  
20 shfaqni faqen 53011.

21 PY. Në fillim fare të faqes, z. Veseli i bëhet pyetje se  
22 çfarë ka qenë G1 dhe G2. Dhe ai thotë që G2 ka qenë  
23 departamenti ose drejtorja për shërbimet informative dhe që ky  
24 vendim është marrë në qershor 1998.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem, a mund të sigurohemi që

1 faqja që është në ekran të tregojë këtë paragrafin që lexoi  
2 Prokurorja.

3 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, se nuk  
4 është e njëjta siç u kërkua.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, faleminderit. Kjo është faqja  
6 e duhur.

7 PY. Mbase ju nuk e keni ditur datën e krijimit, megjithatë  
8 besoj që kjo është në pajtim me atë që e keni kuptuar ju që ky  
9 departament ka ekzistuar përpara nëntorit. A është e vërtetë  
10 kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, si drejtori e shërbimit informativ.

12 PY. Keni shkuar në Shqipëri në shtator 1998. Na keni thënë më  
13 herët që keni udhëtuar së bashku me një grup ushtarësh  
14 përfshirë këtu edhe Arben [Sipas përkthimit] Kuqin. Kjo jepet  
15 në Pjesën 13 [Sipas përkthimit], në faqen 30. Bashkë me ju  
16 udhëtoi edhe Kadri Veseli apo ai ishte në Shqipëri, apo është  
17 larguar për në Shqipëri pas jush? Çfarë mund të na thoni  
18 lidhur me këtë?

19 PË. Jo, me neve me atë grup kur kam dalë unë nuk ka qenë  
20 Kadri Veseli. Unë kam qenë veç me grupin që kam dalë me ta në  
21 Shqipëri. Por, nuk më kujtohet a ka qenë përpara në Shqipëri  
22 apo masanej ka ardhur. Nuk e di atë. E di që në Shqipëri  
23 masanej e kam taku.

24 PY. Kjo është një çështje e cila është diskutuar disa herë.  
25 Ju më pas u larguat nga Shqipëria dhe udhëtuat në disa vende

1 në Evropën perëndimore. Keni thënë që nuk jeni kthyer në  
2 Shqipëri deri nga fundi i tetorit. Për procesverbal është  
3 dhënë në faqen 14, faqen 30 -- Pjesa 14, faqja 30. Tani për të  
4 qenë të qartë për pjesën më të madhe të shtatorit dhe të  
5 tetorit ju nuk keni qenë fizikisht bashkë me Kadri Veseli. A  
6 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Z. Veseli, në këtë intervistë që e ceka pak më herët, ka  
9 thënë se çfarë ka bërë gjatë periudhe. Në fund të kësaj  
10 faqeje, z. Veseli i bëhet pyetje se kur ka ndodhur trajnimi i  
11 parë për inteligjencën, për zbulim-kundërzbulim.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kështu që i kërkoja Sekretarit të  
13 kalojmë tek faqja tjetër e dokumentit që është 53012.

14 PY. Ai thotë:

15 "Ne kemi pasur stërvitje të vazhdueshme, por ne e kemi  
16 filluar stërvitjen e parë nga tetori ose shtatori i 1998. Nuk  
17 po specifikoj në cilin vend, por kemi filluar trajnimin e 20  
18 djemve të rinj."

19 Intervistuesi thotë:

20 "Në vend evropian, besoj ..."

21 Dhe Kadri Veseli thotë:

22 "Shumica e atyre të rinjve kanë qenë studentë ose  
23 intelektualë të rinj. Pjesa dërmuese e tyre kanë qenë  
24 udhëheqës të lëvizjes studentore."

25 Intervistuesi pyet:

1 "A e keni ruajtur këtë bërthamë më vonë?"

2 Kadri Veseli përgjigjet:

3 "Kjo në fakt ka qenë bërthama e Shërbimit Informativ të  
4 Kosovës."

5 A keni qenë në dijeni të kësaj, Dëshmitar, apo nuk e keni  
6 ditur se çfarë ka bërë ai gjatë shtatorit 1998?

7 PË. Është e saktë, nuk e kam, çka ka bo nga shtatori 1998.

8 PY. Ndërkohë që kemi dokumentin këtu në ekran dua t'ju lexoj  
9 një tjetër pjesë. Të kalojmë tek faqja 53008. Këtu flitet për  
10 marrëveshjen e Rambujesë. Ju lutem lexojeni me mend pyetjen  
11 dhe përgjigjen.

12 Ai përmend një takim me tre prej komandantëve të zonave  
13 në Obrij [Sipas përkthimit]. A të kujtohet ky takim,  
14 Dëshmitar?

15 PË. Jo, s'më kujtohet.

16 PY. Ajo çfarë thotë ai a është në përputhje me atë që keni  
17 kuptuar ju situatën që kur çështja është shpjeguar nga  
18 delegacioni, komandantët e zonës e kanë mbështetur atë?

19 PË. Po.

20 PY. Kalojmë në një temë tjetër.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarit që t'i  
22 heqë dokumentat nga ekрани.

23 PY. Ju bënë disa pyetje lidhur me strukturat politike të UÇK-  
24 së. Sa keni qenë i përfshirë ju, Dëshmitar, në çështjet  
25 politike të UÇK-së?

1 PË. Nuk kam qenë shumë i përfshim, për shkak se u ndahet vetë  
2 drejtoria politika që është marrë me ato çështje. Unë jam  
3 marrë më shumë me çështje ushtarake. Shumë pak nga ky kamp.

4 PY. A keni marrë pjesë në takime, në takimet e brendshme të  
5 UÇK-së që kanë pasur përfaqësuesit politikë të UÇK-së ndërmjet  
6 vedit?

7 PË. Jo, të përfaqësuesve politikë që kanë qenë bashkë në  
8 takime, s'kam marrë pjesë unë aty. Se ato nuk a kanë e imja të  
9 mirrem me përfaqësues politikë.

10 PY. A të kanë informuar ty ata lidhur me mënyrën se si kanë  
11 qenë të organizuar dhe strukturuar brenda për brenda,  
12 Dëshmitar?

13 PË. Jo. Nuk, nuk, nuk e kam pas atë bisedë qysh ka qenë më të  
14 organizum ma tutje.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të  
16 paraqesë në ekran videon 103211-07 dhe transkriptin në  
17 anglisht që mban të njëjtin numër dhe vazhdon më tej me TR-AT.

18 PY. Është një transmetim nga 16 shtatori 1998.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të  
20 transmetojë nga fillimi i videos deri në sekondën 53.

21 [Luhet videoincizimi]

22 MASHKULL I PAIDENTIFIKUAR: "... shpreh ngushëllime si  
23 përfaqësues i drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm  
24 Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës. I shpreh ngushëllime familjes  
25 së deputetit dhe pishtarit të demokracisë, z. Azem Hajdari. I



1 shpreh ngushëllime Presidentit të Republikës, Parlamentit të  
2 Republikës së Shqipërisë dhe Partisë Demokratike për anëtarin  
3 e tyre. Me këtë rast, dëshiroj që në emër të Shtabit të  
4 Përgjithshëm të distancohem nga të gjitha vandalizmat e bëra  
5 kundër institucioneve të shtetit dhe të dënojmë përpjekjen për  
6 grusht shteti në Shqipëri. Sipas thashethemeve ...”

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta ndërpresim këtu,  
8 Sekretar.

9 PY. Së pari, a mund të na thoni kush është ky personi që flet  
10 në këtë video, Dëshmitar?

11 PË. Në video fol Xhavit Haliti.

12 PY. Ai përmend vrasjen e Azem Hajdarit dhe një përpjekje për  
13 grusht shteti në Shqipëri. A ju kujtohet që këto ngjarje të  
14 ketë ngjarë apo të kenë ndodhur në shtator 1998, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Për t'ju ndihmuar për të orientuar lëvizjet tuaja, në  
17 shtator a keni qenë në Shqipëri kur kanë ndodhur këto ngjarje  
18 apo ishit larguar për në Evropën perëndimore?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dua të di se  
20 si lidhet kjo me kundërpyetjet?

21 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si lidhet kjo  
22 me kundërpyetjet?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Lidhet me ekzistencën e  
24 drejtorisë politike që mund ta identifikojmë që në fjalinë e  
25 parë të folësit.

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
2 vazhdoni.

3 PY. Mund ta përsëris edhe një herë këtë pyetje. A keni qenë  
4 në Shqipëri kur kanë ndodhur këto ngjarje, Dëshmitar, apo  
5 ishit larguar nga Shqipëria?

6 PË. Kur kanë ndodhur këto ngjarje, faktikisht nja dy ditë  
7 pasi është bërë vrasja e Azem Hajdarit, kam mbërri në  
8 Shqipëri, faktikisht kam mbërri aty në Tiranë. Kështu që kam  
9 qenë aty kur ka ndodh kjo vrasje.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të  
12 pranohet si provë videoja si dhe transkripti përkatës në  
13 anglisht dhe në shqip.

14 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
15 kundërshtime?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se bëhet fjalën vetëm për  
17 këtë pjesën që sapo u transmetua, nuk kam kundërshtim.

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj që  
19 kërkoni vetëm pjesën e transmetuar, apo jo?

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të jetë e gjithë videoja  
21 sepse është një video e shkurtër. Mendoj që do të ishte më e  
22 thjeshtë që të pranohet e gjithë videoja. Megjithatë, nuk kemi  
23 kundërshtim në qoftë se vendosni që të pranohet vetëm ajo  
24 pjesa që dëgjuam.

25 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni dua t'ju  
2 them bazën e shqetësimit tim.

3 Përshkrimi i videos në listën e dokumenteve të  
4 Prokurorisë është shumë ndryshe nga qëndrimi që iu vendos  
5 përpara dëshmitarit. Domethënë në qoftë se -- atëherë vetëm në  
6 qoftë se bëhet fjalë për pyetjen që u bë nga Prokurorja, nuk  
7 është se kam kundërshtim që të pranohet pjesa që sapo u  
8 transmetua dhe sapo u dëgjua.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, përmbajtja e  
10 plotë e asaj çfarë u transferua është minimalja që mund të  
11 kërkojmë që të pranohet.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë këtë po kërkoj. Pra, po kërkoj  
13 në qoftë se kërkohet pranimi si provë i pjesës që ne dëgjuam  
14 të transmetuar, nuk kam kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Le  
16 të pranojmë këtë pjesës deri tani.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
18 dokumenti me ERN 103211-07 dhe transkriptet përkuese në  
19 anglisht dhe në shqip do të marrim numrin e provës 10448. Do  
20 të klasifikohen si publike për pjesën e transmetuar.  
21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

24 PY. Ju bënë disa pyetje lidhur me rolin e Azem Sylës sa i  
25 takon emërimeve. Ju bëtë disa sqarime lidhur me këtë që janë

1 reflektuar në Shënimin Përgatitor numër 1. Do të doja t'ju  
2 jepnim mundësinë ta shihnit, është paragrafi 12, i Shënimit  
3 Përgatitor numër 1.

4 "[Dëshmitari] ka sqaruar se ka rekomanduar për emërimë  
5 tek anëtarët e drejtorisë operative, Rexhep Selimi dhe Sokol  
6 Bashota. [Dëshmitari] nuk ka qenë pjesë e komunikimeve të  
7 mëpasshme apo diskutimeve dhe nuk e di se kush i ka bërë  
8 emërimet konkrete në atë kohë apo kush i merrte vendimet në  
9 atë kohë, pra në [verën] e 1998."

10 A është ky informacion i saktë?

11 PË. Po, saktë.

12 PY. Në përgjithësi, sa emërimë, rekomandime i ke dhënë  
13 drejtpërdrejtë Azem Sylës përkundrejt anëtarëve të tjerë të  
14 Shtabit të Përgjithshëm në qoftë se i keni dhënë ndonjë  
15 rekomandim?

16 PË. Sa i përket 1998 deri në tetor o nëntor nuk kam dhënë  
17 asnjë rekomandim Azem Sylës se nuk ka qenë afër për t'i dhënë  
18 rekomandime. Po më herët, domethënë, në ato që i cekëm që kam  
19 shpjegue pjesën deri në korrik është që kam dhënë propozimet  
20 për shtabin lokal të Suharekës dhe Prizrenit, jo më vonë. Dhe  
21 në fund të 1998, kur u ristrukturue Shtabi i Përgjithshëm dhe  
22 ka filluar ristrukturimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po,  
23 kam dhënë propozimin edhe për komandantin e zonës së  
24 Pashtrikut që ku është -- për t'u emëruar. Dhe ndonjë  
25 komandant brigade të sillet, sidomos eprorëve të cilët kanë

1 arrit në atë kohë. Por jo edhe ma tepër.

2 PY. Këto propozime për shtabin lokal në Suharekë dhe në

3 Prizren ishin, ishin pra, iu dhanë -- ose ja dhatë

4 drejtpërdrejtë këto rekomandime, këto propozime?

5 PË. Jo, unë kjesh shumë i kjartë atëherë kur më kanë pytun që

6 këto propozime ja kam dhënnun drejtorisë operative, Sokol

7 Bashotës, i cili më ka udhëzu të shkoj në këto shtabe për t'i

8 ndihmuar për t'u riorganizuar.

9 PY. Të ndryshojmë sërish temë. Gjatë dëshmisë keni thënë se

10 shumë nga detyrat e Shtabit të Përgjithshëm ishin detyra

11 koordinimi. A mund të na përshkruani disa nga koordinimet që

12 kërkoheshin në nivel të Shtabit të Përgjithshëm?

13 PË. Po koordinimet janë kur të koordinohen mes -- drejtoritë

14 mes vedit për veprimin e punës dhe Shtabit të Përgjithshëm.

15 Është koordinim edhe ajo në qoftë se, për shembull, e cekëm

16 edhe te shtabet lokale për shembull ku jipet propozimi se si

17 duhet të emërohet dikush si komandant apo të koordinohet në

18 ato se sa është zhvilluar njësi më poshtë e shtabeve lokale.

19 Se zhvillimet e saj kur thuhet koordinimi të bëhet për shkak

20 se në ato komandanta nuk është vetëm një komandant që

21 emënohet, por ka zëvendësa, ka sektorëve të ndryshëm që

22 emënohen për me mujt me funksionu një komandë. Kështu edhe nga

23 ky aspekt kanë qenë koordinimet në shtab për veprimin e

24 shtabit gjatë kësaj periudhe.

25 PY. Kjo që përshkruani ju është roli juaj?

1 PË. Po, është roli jem edhe të tjerëve kush kanë drejtoritë  
2 veç e kanë -- veç drejtoritë, edhe ata kanë pas atë,  
3 domethënë, koordinimin që është koordinu bashkë. Për shembull,  
4 koordinimi ma tutje e kemi vazhdu edhe me z. Selimi, edhe me  
5 z. Bashota, edhe gjatë verës 1998 gjatë ofensivave. Edhe ajo  
6 është një pjesë koordinimi që bëhet mes veti.

7 PY. Tani të shohim më konkretisht disa nga zonat. Fillojmë me  
8 Ramush Haradinajn.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim në ekran materialin  
10 P01356. Na duhet fundi i faqes 6018 dhe kalojmë në faqen  
11 tjetër. Është dëshmia juaj në rastin Sainovic, në çështjen  
12 Sainovic. Në këtë pjesë të dëshmisë, ju kanë treguar  
13 procesverbalin e takimit të 23 qershorit 1998 në Dukagjin, të  
14 njëjtat shënime që ua treguar disa herë këtu gjatë dëshmisë  
15 suaj. Pyetësi citon dokumentin, është diçka që ka thënë Ramush  
16 Haradinaj dhe thotë:

17 "Kjo luftë sot i përket të gjithë popullit, jo vetëm një  
18 grupi. Ka lidhje me lirimin e vendit. Duke i njohur kërkesat e  
19 një lufte të një zone që ka rëndësi gjeostrategjike, lufta  
20 jonë duhet shtrirë më tej. Duhet të kemi një ushtri të  
21 rregullt."

22 Pastaj iu është bërë një pyetje ju.

23 "Dhe e mendoj se është e drejtë të themi që edhe ju jeni  
24 ndjerë në të njëjtën formë, apo jo?"

25 Dhe ju jeni përgjigjur:

1 "Po, dhe në këtë drejtim kemi punuar."

2 Pyetja ime është kjo: Ramush Haradinaj e kishte kuptuar  
3 rëndësinë e një strukture ushtarake dhe a punonte në këtë  
4 drejtim? A e keni marrë këtë përshtypje nga bashkëbisedimi me  
5 të?

6 PË. Po, ka punu në këtë drejtim rreth ristrukturimit të  
7 shtabit të zonës së vet, zonës operative. Dhe këtë përshtypje  
8 kam pasur pas takimeve ku kam vizitue zonën e Dukagjinit, por  
9 edhe ma herët kur kam qenë, se ai ka pas edhe në kuadër - vetë  
10 - i ka pas edhe më duket katër apo pesë eprorë ushtarakë të  
11 ish-armatës të cilët i kanë ndihmuar për ristrukturim.

12 PY. Gjatë dëshmisë suaj kemi parë disa raporte që i keni  
13 dhënë Shtabit të Përgjithshëm, por edhe dokumente ku  
14 konfirmohet se kishit zbatuar urdhrat të lëshuara prej tyre.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Tani shohim materialin që mban  
16 numrin IT-04-84 T3364. Anglishtja është faqja 12 në PDF.  
17 Shqipja faqja 13 në PDF.

18 PY. Dokumenti që po presim të shfaqet në ekran është dëshmia  
19 juaj në çështjen Haradinaj. Unë do t'ju lexoj pjesën  
20 përkatëse. Pyetja që ju kanë bërë ishte kjo:

21 "... në kohën që mbërritët Ramush Haradinaj ishte i  
22 kënaqur që të ishte zëvendës komandant në vartësinë e Tahir  
23 Zemajt?"

24 "PË. Po, ai po vepronte në këtë cilësi dhe kur bisedova  
25 me të më tha se do t'i bindej çdo urdhri që i vinte nga

1 shtabi. Por shtabi kishte marrë një vendim për ta ricaktuar  
2 atë në komandë.”

3 Informacioni që sapo ju lexova, a është i saktë?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është sugjestionuese. Kjo  
5 s'është pjesë e provave gjyqësore. Nuk është normale që  
6 thjesht të lexoni një pjesë të dëshmisë e t'i bëni pyetje.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, t'ua përsëris edhe një herë pyetjen. Po ju  
10 pyesja në qoftë se informacioni që sapo ju lexova që keni  
11 dhënë dëshminë tuaj të mëhershme a është i saktë?

12 PË. Po.

13 PY. Nuk do flas për të gjitha zonat. Por tani të shohim  
14 Shalën. Në verën e 1998 Shala a ka qenë një nga zonat aktive,  
15 ç'ka do të thotë a ka pasur shumë luftime në atë zonë?

16 PË. Po, gjatë verës 1998 deri - më shkurt - deri vonë deri ka  
17 fundi -- gushti, shatori, jo, nuk ka pas shumë luftime në atë  
18 drejtim. Po në periudhën më vonë, po. Faktikisht ofensiva kur  
19 ka fillu, serbe, në 1998, por jo më herët si këto të tjerat që  
20 kanë [E pakuptueshme]. Kur folim aktive, më aktive ka qenë  
21 Drenica dhe Dukagjini në atë kohë kur kam mbërritur prej fundit  
22 të majit e deri sa kanë filluar luftimet e mëtutjeshme,  
23 domethënë, faktikisht prej Rahovecit, prej korrikut. Pastaj ka  
24 fillu në të gjitha zonat, në të gjitha territorit. Po  
25 aktiviteti më i madh ka qenë më shumë te zona e Dukagjinit



1 edhe e Drenicës.

2 PY. Pra një ngjarje që ka ndodhur në atë kohë në zonën e  
3 Shalës ka ndodhur sulmi tek Bardhi i Madh. A ju kujtohet që ju  
4 bënë pyetje lidhur me këtë incident. Dhe ju e konfirmuat se  
5 ishit takuar me zëvendëskomandantin e zonës operative të  
6 Shalës për këtë incident. Kush ishte zëvendëskomandant i  
7 Shalës me të cilin u takuat ju?

8 PË. Po. Në atë kohë komandant ka qenë Mensur Kasumi.

9 PY. Mensur Kasumi ju ka raportuar për këtë incident?

10 PË. Po.

11 PY. Tani do të flasim për periudhën kur keni qenë shef  
12 shtabi.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem vendosim në ekran  
14 materialin P00228.

15 PY. Ky është raporti i 28 dhjetorit të cilin e keni  
16 përgatitur ju dhe ju kanë bërë shumë pyetje lidhur me këtë  
17 raport gjatë kohës që keni qenë këtu, por edhe sot.

18 Tek paragrafi i parë keni renditur zonat prej të cilave  
19 keni marrë raporte me shkrim. Këtu është Shala dhe disa zona  
20 të tjera. Kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Kur po përgatisnit këto raporte, ju synonit t'i jepnit  
23 informacione të sakta zëvendëskomandantit?

24 PË. Po, synonim ato, se kjo është një përmbledhje e  
25 raporteve, e kam cekë edhe një herë. Kjo është përmbledhja e

1 raportit, raporteve të komandantave. Dhe kjo përmbledhje iu  
2 është dhënë faktikisht zëvendëskomandantit edhe komandantit që  
3 të informohen me raportimet e komandantëve të zonave në atë  
4 kohë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3.

6 PY. Paragrafi për forcat ushtarake, aty ku thotë "forcat  
7 tona", raporti thotë:

8 "Pas sulmeve të gjitha forcat janë vendosur në [zonat  
9 operative] dhe mund të themi që territori kontrollohet më  
10 shumë nga forcat tona krahasuar me periudhën para ofensivës.  
11 Është bërë përpjekje që të bëhet koordinimi i forcave të UÇK-  
12 së -- njësive të UÇK-së, më falni, në qytete, dhe në ato pjesë  
13 që nuk janë ende në njësitë e rregullta të UÇK-së. Linja e  
14 vartësisë që nga niveli më lart i komandës, [Shtabi i  
15 Përgjithshëm] e deri poshtë tek skuadrat, është në nivel të  
16 përshtatshëm."

17 A është ky një informacion --

18 PË. Po, është një informacion i cili e kanë dhënë komandantët  
19 e zonave në atë kohë dhe është përmbledhur dhe është dhënë  
20 zëvendëskomandantit. Domethënë, për ndodhitë në zonat që po  
21 ndodhin, territoret sa i ka që i kontrollojnë, dhe sa kanë  
22 arritur në nivelin e tyre [E pakuptueshme] drejt  
23 ristrukturimit brendapërbrenda zonave.

24 PY. Do të ndryshoj temë. Në kontekst të Shtabit të

25 Përgjithshëm, kur thoni "komanda" për kë e keni fjalën?

1 PË. Komanda, në komanda kur them në Shtab të Përgjithshëm  
2 konteksti i Shtabit të Përgjithshëm është komandant edhe  
3 zëvendëskomandanti.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do t'ju lexoj një pjesë të  
5 transkriptit. Është T17642. Po lexoj nga rreshti 10 tek  
6 anglishtja.

7 PY. Thuhet:

8 "Pra, pikësëpari, personi që u emërua ishte Sokol  
9 Dobruna, apo jo?"

10 Përgjigja juaj:

11 "Po, kështu."

12 "PY. Dhe ai u emërua me propozim të z. Syla, kështu?"

13 Përgjigja juaj:

14 "Po, të komandës, si dhe ishte një propozim -- me  
15 propozim të komandantit të zonës së Dukagjinit."

16 Dhe pastaj vazhdon pjesa tjetër e dëshmisë tuaj.

17 Për kë e keni fjalën kur thatë "po, nga komanda". Ishte  
18 diçka kolektive kjo, bashkërisht, apo kishte një person  
19 konkret që e kishte bërë propozimin. Gjithmonë ju pyes për atë  
20 që dini. Në qoftë se nuk dini diçka lidhur me këtë mund të na  
21 e thoni.

22 PË. Po e them këtë kështu se me kërkesën kur është bërë për  
23 t'u plotësuar ristrukturimi normalisht është kërkuar nga zona  
24 sidomos të sektorit juridik, dhe në atë kohë kur komanda ka  
25 kërkuar nga sektori juridik -- nga zonat, zona e Dukagjinit e

1 ka ofrue domethënë, komandanti i zonës e ka ofru Sokol  
2 Dobrunën, një person i cili ka kry shkollimet adekuate për  
3 çështje juridike dhe që ka përvojë. Për atë edhe është  
4 propozue në komanda. Komanda pastaj e ka aprovuar.  
5 PY. Brenda komandës kush e ka bërë konkretisht. A dini apo  
6 thjesht ju e dini komanda?  
7 PË. Jo, nuk e di kush e ka nënshkru atë, po e di që pjesë e  
8 komandës, po. Se është niveli i saj se është shumë mirë  
9 propozimi kur është bë, ose kërkesa prej komandantit të zonës  
10 dhe për ç'ka është dërguar ai person, i cili është dërguar për  
11 çështje juridike në kuadër të kabinetit të komandantit të  
12 përgjithshëm.

13 PY. Ndryshojmë sërish temë. Kur iu bënë pyetje se në cilat  
14 keni qenë të përfshirë, sa i takon takimeve që duhet të  
15 organizonit ju, ju keni thënë kështu që ju keni qenë i  
16 përfshirë për organizimin e takimeve me komandantët e zonave  
17 dhe me drejtoritë.

18 A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykues cili ishte dallimi  
19 mes takimit të drejtorive dhe takimit të përgjithshëm --  
20 takimit të Shtabit të Përgjithshëm?

21 PË. Dallimi ka [E pakuptueshme] takimi i drejtorive është kur  
22 takohen drejtoritë dhe rendisin punët ose koordinojnë punët  
23 brenda Shtabit të Përgjithshëm, po edhe nevojat të cilat i ka.  
24 Ose për detyrat dhe përgjegjësitë që i kanë drejtoritë. Kur  
25 folim Shtabi i Përgjithshëm atëhere dhe komanda edhe

1 drejtoritë operative dhe gjithë marrin pjesë në takim dhe kur  
2 mund të shqyrtohet çështje të ndryshme edhe ato ç'ka nevojë  
3 për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.  
4 PY. Pamë një takim të drejtorive që kishit organizuar ju më  
5 29 dhjetor 1998. Aty është ky takimi që dhatë dhe një  
6 prezantim për strukturën. Ju kemi treguar edhe disa shënime të  
7 tjera nga takimi i 29 dhjetorit.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund t'i shohim sërish, kemi dy  
9 paketa por të shënimeve të ngjashme. Dhe do të doja t'ju jepja  
10 mundësinë që t'i shihnit ju vetë. Fillimisht vendosim në ekran  
11 materialin me numër P01104.

12 PY. Ju lutem hidhini një sy këtyre shënimeve. Është edhe  
13 rendi i ditës këtu. Këtu bëhet fjalë për një marrëveshje të  
14 nënshkruar nga Sokol Bashota. Është diskutuar çështja e Blerim  
15 Kuqit. Treshi thotë "Të ndryshme".

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shohim poshtë edhe faqen tjetër  
17 që të shohë të plotë faqen dëshmitari.

18 PY. Këtu ju nuk përmendeni në këto shënime. Do të shkojmë  
19 tani tek paketa tjetër e dokumenteve.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I keni parë edhe më përpara këto.  
21 Ka numrin e provës P01109. Faqja konkrete që na nevojitet me  
22 numër 2865.

23 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
24 Prokurore, ju lutem përfundoni këtë linjë pyetjesh por duhet  
25 të përfundojmë seancën për ditën e sotme dhe dëshmitari të

1 largohet.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, do të mbaroj vetëm me këtë  
3 dokument.

4 PY. Dhe këtu mund të shihni rendin e ditës. Dhe këtu ka gjëra  
5 të ngjashme, zona e Pashtrikut, e Llapit, përmendet rasti i  
6 Blerim Kuqit, por edhe këtu ju nuk përmendemi dhe nuk  
7 përmendet prezantimi që u keni dhënë atë ditë drejtorive.

8 Tani që patët mundësinë dhe i patë këto shënime, por edhe  
9 bazuar në kujtesën tuaj, shënimet që sapo pamë janë shënime të  
10 takimit të drejtorive që kishit organizuar ju, apo janë  
11 shënime të takimit të Shtabit të Përgjithshëm në përgjithësi?  
12 PË. S'më kujtohet tash. Po sigurisht ky ka qenë të Shtabit të  
13 Përgjithshëm si takim. Se me pas qenë të drejtorive, atëhere  
14 kishin caktu drejtorat kush janë që marrin pjesë dhe kishin  
15 fol për drejtorinë. Unë mendoj se është e Shtabit të  
16 Përgjithshëm.

17 PY. Faleminderit. Sikurse e tha Gjykatësi duhet të  
18 përfundojmë tani seancën.

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
20 z. Zyrapi për ditën e sotme. Për sot përfunduar. Nesër keni  
21 vetëm dy seancat e paradites. Faleminderit që ishit i  
22 pranishëm. Tani mund të largoheni dhe mos harroni që s'duhet  
23 të flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit.

24 Mbrëmje të këndshme.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni.

2 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam çështje shpejt e shpejt. Një,  
4 ne do të kërkojmë një verifikim transkripti ose më saktë  
5 përkthimi se tek pyetja që i bëri Prokurorja "Kush e emëroi  
6 Sokol Dobrunën", nuk është përkthyer një pjesë e përgjigjes.  
7 Duam ta verifikojmë këtë, sepse s'i e kuptuam ne, ai tha që  
8 është bërë propozim nga komandanti i zonës në mënyrë që të  
9 emërohej tek sektori juridik, po ka ngelur një pjesë e pa  
10 përkthyer që mendoj se ka qenë "brenda kabinetit të  
11 komandantit të përgjithshëm".

12 Diçka tjetër, dëshmia e dëshmitarit tek intervista e ZPS-  
13 së për pjesën e emërimeve - më falni - është në provën  
14 materiale P01356, faqja 428, ku thotë se është bërë me  
15 propozim të komandantit të përgjithshëm. Po e them këtë për  
16 procesverbal dhe meqë tani kanë dalë prova të reja gjatë  
17 pyetjeve plotësuese dhe në bazë të të cilave ne duhet të bëjmë  
18 kundërpjetje, po ju informoj paraprakisht.

19 Edhe një herë, sa i takon vendimit që morët ju që  
20 Prokuroria mund t'i nxjerrë me vonesë materialet, edhe duke  
21 thënë se ju thoni që ne mund të bëjmë kundërpjetje shtesë, unë  
22 dua të shtoj se edhe ne kemi kërkuar gjithmonë leje që të  
23 shtojmë dokumente në listën tonë të materialeve për të  
24 trajtuar pyetje të Trupit Gjykes edhe tani po ju them: A do  
25 të zbatoni ju të njëjtin parim edhe për ekipet e Mbrojtjes?

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju them  
2 nesër paradite për vendimin tim përfundimtar.

3 Rifillojmë nesër në orën 9.00.

4 --- Seanca mbyllet në orën 16.33

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25